

1 E martë, 9 korrik 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Sekretar,
6 paraqisni lëndën.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar
8 Gjykatës. Kjo është dosja gjyqësore me numër KSC-BC-2020-06,
9 Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
10 Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Faleminderit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
12 Vërej se të akuzuarit janë të pranishëm në sallë sot. Do të
13 vijojmë me dëgjimin e dëshmisë së Dëshmitarit 07452.

14 Përpara se të vijojmë, nuk e di, z. Emmerson, nëse mund
15 të na informoni se sa kohë ju kanë mbetur për pyetjet?

16 Z. EMMERSON: [Përkthim] Mendoj se do të përfundojmë
17 përpara pushimit të orës 11.00.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mundet një
19 përditësim nga dy avokatët e tjerë?

20 Z. ROBERTS: [Përkthim] Mendoj që gjashtë orë është
21 vlerësimi im tani për tani. Me shumë gjasë do të jetë më pak,
22 pesë përfaqësisht për të, por do të shikojmë sesi do të
23 shikojnë pyetjet e tjera të z. Emmerson dhe edhe me fillimin e
24 pyetjeve të mia.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë.

1 Znj. Alagendra.

2 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] NE fillimisht kemi thënë tetë
3 orë, tani e kemi gjashtë orë e gjysëm. Por duke pasur parasysh
4 edhe provat shtesë të paraqitura, mund të rikthehemi tek
5 vlerësimi fillestar.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

7 Znj. Asistente e sallës, shoqëroni dëshmitarin në hyjë në
8 sallë.

9 [Dëshmitari vijon dëshminë]

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi,
11 z. Zyrapi dhe Avokati Kujdestar, mirëmëngjesi.

12 DËSHMITARI: Mirëmëngjesi.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju rikujtoj
14 që t'ju përgjigjeni pyetjeve qartë me përgjigje të shkurtra.
15 Nëse nuk e kuptoni një pyetje, lirisht mund t'i kërkon
16 avokatëve t'jua përsërisin pyetjet, mund të thoni që s'e
17 kuptoni dhe ata mund t'jua sqarojnë.

18 Gjithashtu na sqaroni se nga i dini faktet dhe rrethanat
19 për të cilat do t'ju bëhen pyetjet.

20 Flisni afër mikrofonit dhe prisni pesë sekonda përpara se
21 t'i përgjigjeni një pyetje dhe pastaj flisni ngadalë në mënyrë
22 që t'ju arrijnë përkthyesit.

23 Nëse keni nevojë për pushim, ju lutem na e bëni me dije
24 dhe do t'ju plotësohet kjo nevojë.

25 Ju rikujtoj se jeni ende nën betim për të thënë të

1 vërtetën siç e thatë në betimin tuaj solemn. Ju rikujtoj
2 gjithashtu, siç ju informuam javën që shkoi, nuk jeni të
3 detyruar që t'iu përgjigjeni një pyetjeje e cila ju fajëson,
4 t'iu përgjigjeni një pyetjeje me përgjigje fajësuese përpos
5 rastit kur Trupi Gjykyes mund t'ju detyrojë për të dhënë një
6 përgjigje, gjithashtu edhe Avokati Kujdestar që ju është
7 caktuar mund t'ju paraqesë një çështje përpara Trupit Gjykyes
8 për rrethana të caktuara.

9 Do të vijojmë tani me pyetjet që do t'ju bëjë Avokati
10 Mbrojtës i z. Veseli.

11 DËSHMITARI: BISLIME ZYRAPI [Vijon]

12 Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson:

13 [Vazhdim]

14 Z. EMMERSON: [Përkthim

15 PY. Mirëmëngjesi, z. Zyrapi.

16 PË. Mirëmëngjesi.

17 PY. Kur e ndërpreme dje në drekë seancën, sapo ju kisha

18 lexuar disa pasazhe nga një deklaratë e dëshmitarit e

19 nënshkruar apo e dhënë nga Mensur Kasumi. Ju kujtohet, në

20 përgjithësi të themi, pasazhet që jua lexova?

21 PË. Po.

22 PY. Tani kam disa pyetje lidhur me ato pasazhe mbështetur

23 në/ose lidhur me përshkrimet që ka dhënë z. Kasumi sa i takon

24 emërimit të tij dhe rolit të tij.

25 Pikë së pari, a e kam kuptuar qartë që përpara mbërritjes

1 së Mensur Kasumit përpara ardhjes së tij aty, nuk kishte
2 askush që të bënte diçka në lidhje me zbulimin në nivel të
3 Shtabit të Përgjithshëm ndërkohë që z. Veseli ishte jashtë
4 vendit?

5 PË. Po.

6 Z. EMMERSON: [Përkthim] Dëshiroj të shikojmë tani provën
7 me numër P182, faqe SPOE00226401.

8 PY. Mund të më korrigjoni nëse e kam gabim, por kjo ka datën
9 6 shkurt. Është një koment i mbajtur shënim në një takim ku ka
10 marrë pjesë z. Rustem Mustafa dhe është një koment i cili
11 thuhet se e ka thënë, u takon shënimeve të mëhershme të
12 Rustem Mustafës. Është ankesa për të cilën kemi folur në atë
13 takim në lidhje me marrëdhënien midis Shtabit të Përgjithshëm
14 dhe komandantëve të zonave. Ankesa konkrete e cila ceket këtu
15 është se shërbimi i sigurimit nuk mund të sigurojë ushtrinë
16 nga jashtë. Është në rreshtin e parë, Pjesa e Parë. E shihni?

17 PË. Po. E shoh. Po.

18 PY. A ju kujtohet që është bërë kjo ankesë?

19 PË. Ankesa ka pas çdo herë, të shumta. Tash s'po kujtoj saktë
20 bash është kjo, po ka pas ankesa.

21 PY. Konkretisht ankesa për faktin se ishte e pamundur që të
22 drejtohej një shërbim zbulimi nga jashtë? Ju kujtohen shumë
23 ankesa për këtë apo shumë ankesa për gjëra tjera?

24 PË. Zakonisht komandantët kur kanë ardh kanë pas ankesa jo
25 veç në këtë drejtim, kanë pas edhe tjerat edhe në furnizime,

1 në plotësim edhe të kuadrove tjera. Kështu që ka pas kërkesa.

2 PY. Po. Mirëpo kjo është bërë ditën e parë të Rambujesë, ku

3 padyshim z. Veseli ndodhej në Rambuje. Kështu që unë po ju

4 pyes lidhur me këtë, nëse ka pasur ankesa të cilat ju janë

5 drejtuar juve sa i takon mungesës së një shërbimi zbulimi që

6 të ishte në funksionim brenda Kosovës?

7 PË. Po, po.

8 PY. Sepse është thuhet se atëherë kur Mensur Kasumi ju

9 bashkua Shtabit të Përgjithshëm, rreth një javë pasi u bashkua

10 Shtabit të Përgjithshëm në departamentin e operacioneve.

11 PË. Në departamentin e operacioneve jo një javë, po më tepër

12 ka se një javë që është bashkuar, po, është saktë q'ashtu.

13 PY. Më falni, po më duket se ZPS-së, në intervistën tuaj më

14 të fundit, i keni thënë se mensur Kosumi ka ardhë në Shtabin e

15 Përgjithshëm nga fundi i janarit apo fillimi i shkurtit, a nuk

16 është kështu?

17 PË. Po, kjartë.

18 PY. Ndërsa kjo pusullë që shohim këtu, ky shënim ka datën e 6

19 shkurtit, pra, pak a shumë, është rreth një javë pasi ai ka

20 ardh në Shtabin e Përgjithshëm. A do të pajtoheshit me mua?

21 PË. Është -- po, është e vërtetë si mbas shkresës dhe takimit

22 që është mbajt.

23 PY. Nëse e kam kuptuar qartë dëshminë tuaj dje, diku nga

24 fundi i seancës përgjigja juaj u ndërpre paksa, por më duket

25 se ju po thoshit nga fundi i seancës, i transkriptit kështu,

1 se edhe pse ai ishte emëruar në departamentin e operacioneve
2 nevoja për të mbledhur, për shembull, informata operative për
3 vënien në shënjestër të forcave serbe, do të thoshte se ai po
4 kryente edhe disa funksione të zbulimit. A nuk është kështu?

5 PË. Po, saktë.

6 PY. Paçka se ai zyrtarisht nuk ishte emëruar si zëvendësues i
7 z. Veseli, gjë që ndodhi në fillim të prillit, pra, ai
8 gjithsesi po i kryente disa funksione të zbulimit, kështu,
9 pra, përpara se të emërohej zyrtarisht?

10 PË. Po, saktë është.

11 PY. Dhe jua kam lexuar deklaratën e tij që ka dhënë si
12 dëshmitar që në thelb funksionet e zbulimit përfshinin
13 mbledhje të sa më shumë informatave operative lidhur me
14 objektivat e mundshme serbe, kështu?

15 PË. Po, saktë.

16 PY. Dhe këtë informacion, këto informata jua kalonte juve?

17 PË. Po.

18 PY. Nëse do të bënim një përmbledhje -- jo ta them ndryshe.
19 Unë do të sugjeroja se kishte tri kategori të përgjithshme të
20 informatave të cilat ishin me rëndësi, në lidhje me kohën që
21 ju keni kaluar në Shtabin e Përgjithshëm. Njëri lloj është
22 informata të cilat vinin nga shërbimet e huaja të zbulimit apo
23 përfaqësues të huaj që vinin në Kosovë përmes kontakteve
24 jashtë vendit.

25 Kategoria e dytë janë informata të përgjithshme lidhur me

1 lëvizjen e trupave serbe apo të pozicioneve apo të vendosjes
2 së tyre, informata të cilat shkonin jashtë apo mbaheshin dhe
3 në Kosovë në varësi të rrethanave. Me fjalë të tjera,
4 informacione të mbledhur anë terren për objektivat legjitime
5 ushtarake dhe pozitat e serbëve dhe kjo është kategoria e dytë
6 e informatave do të thosha.

7 Dhe kategoria e tretë, siç e përshkruat edhe ju në
8 dëshminë tuaj, janë informatat për spiunët brenda ushtrisë,
9 spiunë me uniformë dhe spiunët pa uniformë, kështu?

10 PË. Po, kjartë.

11 PY. Dhe ju janë bërë pyetje lidhur me këtë sa i takon
12 përkufizimit të kolaboracionistëve, do t'i kthehem edhe kësaj,
13 po ju i thatë Trupit Gjykses se përkufizimi kolaboracionistit
14 kishte të bënte vetëm me dikë i cili bashkëpunonte në mënyrë
15 aktive dhe kontribuonte me informacion në dispozicion të
16 forcave armike?

17 PY. Po, saktë.

18 PY. Në deklaratën si dëshmitar të z. Kasumi, siç e shihni, ai
19 thotë se prioriteti më i rëndësishëm, madje, prioriteti i
20 vetëm me të cilin ai mund të merrej ishte që ai mund të
21 përpigëj të gjente informacione për pozitat e serbëve. Tani
22 dua të fokusohem tek kjo për një çast. Kur ju raportonte juve
23 gjatë asaj periudhe, mos ju raportonte edhe ndonjë gjë tjetër
24 përpos pozitive të serbeve, pra, z. Kasumi a ju raportonte
25 edhe për kolaboracionistët brenda ushtrisë apo edhe jashtë

1 ushtrisë gjatë asaj kohe, apo jo? Është pyetje e gjatë
2 faktikisht dhe e përbërë.

3 Keni parë në deklaratën si dëshmitar të z. Kasumi se ai i
4 përshkruan funksionet e tij të zbulimit se kishin të bënë
5 vetëm me mbledhjen e atyre informatave që ai mund të mblidhte
6 lidhur me pozicionet e serbëve. Ju kujtohet kjo pjesë e
7 deklaratës së tij?

8 PË. Po.

9 PY. A është e saktë kjo me aq sa keni u dijeni?

10 PË. Po. Është e saktë, që nga z. Kasumi kam marrë vetëm për
11 lëvizjen e forcave serbe.

12 PY. Sepse ju kujtohet transkripti që keni parë gjatë pyetjeve
13 që jua bëri Prokuroria se një prej njerëzve në fund të
14 rreshtit, pra, në fund të vijës ishte Luli por nuk ishte z.
15 Veseli, emrin faktikisht e kishte Luli dhe ishte një vartës?

16 PË. Po.

17 PY. Dhe në atë transkript, ju dukej që po përpiqeshit të
18 merrnit informacion, siç duket, lidhur me pozicionet e trupave
19 dhe veprimet ushtarake që kërkonte që edhe që të zgjoheshin
20 njerëzit mes natës. Ju kujtohet?

21 PË. Po, kjartë. Po ka dallim mes asaj që unë kam bisedu me
22 personin Luli që është i zonës operative të Llapit, faktikisht
23 që ka qenë në drejtorinë operative e tyre, ajo ka qenë në
24 momentin kur unë kam bisedu me to dhe kam kërku aty
25 informacionet ishin në kohën kur veç ishin luftimet mes

1 forcave serbe dhe forcave të UÇK-së. Kurse kur thoni
2 grumbullim i informacioneve nga forcat serbe, është diçka
3 krejt tjetër. Ajo mund -- informacionet mblidhen edhe para saj
4 e ku janë ato forca, ku po lëvizin, çfarë kanë armë, çka,
5 çfarë qëllimi kanë. Ka dallimeve mes këtij raporti dhe këtij
6 raporti.

7 PY. Megjithatë ju merrni informata për lëvizjet në terren
8 edhe ju vetë në komunikimet e drejtpërdrejta me komandantët në
9 terren, a nuk është kështu? Pra, ky --

10 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
11 klasifikimin, ju lutem.

12 Z. EMMERSON: [Përkthim] Është vetëm data, data e
13 klasifikuar.

14 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Nuk është data është përshkrimi,
15 të nderuar Gjykatës.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të kalojmë
17 në seancë private për këtë.

18 [Seancë private]

19 [Seancë private teksti i fshirë]

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2 [Seancë e hapur]

3 Z. EMMERSON: [Përkthim]

4 PY. Pra, për t'ju kthyer dokumentit në ekran, kjo ankesë që
5 ju keni marrë, kjo ankesë që keni vënë për faktin që shërbimi
6 i sigurimit nuk ishte në gjendje që të kujdesej për ushtrinë
7 nga jashtë, kishte të bënte kjo me arsyen përse ju i kërkuat
8 z. Kasumi të ushtronte këtë funksion gjer në kthimin e z.
9 Veseli?

10 PË. Nuk është veç kjo arsyeja e kësaj, e këtij shkrimi në
11 këtë kohë. Z. Kasumi me ardhjen në Shtabin e Përgjithshëm në
12 detyrën për rrjedhojë e kam drejtu edhe në këtë drejtim që të
13 jepë informacione dhe për G2 ose sektorin e zbulimit dhe
14 kundërzbulimit për arsye se s'kam pas askënd tjetër, meqenëse
15 ai veç ka përvojat edhe mund ta bën këtë detyrë. Dhe ai e ka
16 ushtru këtë detyrë derisa është kthyer z. Veseli dhe
17 faktikisht nuk u bë ndryshimi pastaj edhe i shtabit dhe kalimi
18 i z. Veseli prej shtabit në pjesën civile faktikisht në
19 shërbimin informativ të Kosovës. Tani ai vendosen pastaj dhe
20 tjerët të cilët kanë vendosë, kanë vazhdue në drejtimin në
21 Shtabin e Përgjithshëm si udhëheqës të saj.

22 Po deri në atë kohë, folim prej majit -- prej janarit të
23 cilën z. Kasumi është transferu në Shtab të Përgjithshëm,
24 përveçse ka qenë drejtor, ka kry edhe këtë detyrë. Për arsye
25 se s'kemi pasur kuadro tjerë, nuk kemi pas resurse tjera që

1 t'i zëvendësosh ose të pakëm mu z. Veseli s'më ka lënë dikën
2 që ka qenë dikush mbrenda aty si zëvendës apo që e kryen
3 detyrën e tij. Kjo është. Kjo është përcaktu atëherë dhe ai ka
4 kry këtë detyrë.

5 Edhe jo vetëm këtu, po ka pas mungesë edhe në vende tjera
6 për këto dhe kërkesat e komandantëve kanë qenë të shpeshta.

7 PY. Megjithatë ju e keni caktuar të kryente ato detyra, apo
8 jo?

9 PË. Po.

10 PY. Pra, që të jemi të qartë për këtë, na treguat dje që ka
11 ngjashmëri fjala "zëvendës" dhe "zëvendësues" në gjuhën
12 shqipe. Fakt është që z. Kasumi ka thënë në deklaratën e vet
13 se nuk është takuar me z. Veseli deri në momentin që është
14 kthyer në mars. Kështu i kujtohet atij. Kjo është hera e parë
15 që i kujtohej z. Kasumi të jetë takuar me z. Veseli.

16 Ju po thoni që z. Veseli është kthyer në Kosovë për dy
17 ditë ose nga fundi i shkurtit a fillimi i marsit. A ka të
18 ngjarë të jeni gabuar për këtë? Mbase kujtesa ju nuk ju
19 ndihmon?

20 PË. Mund të gaboj në data, po në kohë jo shumë. Edhe unë nuk
21 kam thënë që strikt është ose fundi i janarit apo fillimi i
22 shkurtit. Në këtë periudhë. Mund të jetë fundi i shkurtit --
23 janarit mund të jetë edhe fillimi i shkurtit. Por zakonisht në
24 qatë periudhë ka qenë dy ditë dhe prapë është kthyer jashtë.
25 Nuk ka shku me delegacione, sikur dhe dje më pyetët dhe ka

1 shku me delegacionin nga brenda po nga jashtë. Se prapë ka
2 dalë jashtë në Shqipëri dhe ka vazhduar prapë të shkon në
3 delegacionin në Rambuje. Ashtu e di dhe e ashtu e mbaj mend në
4 atë kohë.

5 PY. Por jo me delegacionin nga Kosovës?

6 PË. Jo, jo.

7 PY. Mirë.

8 Z. EMMERSON: [Përkthim] Duke marrë parasysh këtë që sapo
9 thatë, sa i takon rolit të z. Kasumi, le të shohim tani një
10 takim të mëhershëm kur e dimë që z. Veseli nuk ka qenë në
11 Kosovë. Është 30 dhjetor data se kemi vulat në pasaportë. Le
12 të shohim tani prova materiale me numër P1109, në faqen U002-
13 2861. Ju lutem në anën e majtë të vendosni shqipen. Po kërkoj
14 faqen 2861 në të dyja dokumentet. Kjo është ajo që na duhet.
15 Zmadhoheni pak, ju lutem, që ta shohim të plotë në ekran. Më
16 saktë zvogëloheni pak që të shohim faqen e plot.

17 PY. Ky është një takim, më saktë një procesverbal, një end
18 dite i një takimi që është mbajtur për të diskutuar ndër të
19 tjera përbërjen, propozimin për komisionin kadrovik. Ju na
20 thatë që komisioni kadrovik nuk u bë asnjëherë. Por ajo që më
21 intereson mua në fakt, është pika C.

22 Z. EMMERSON: [Përkthim] Fokusohuni pak tek pika C që
23 është drejt fundit të faqes.

24 PY. Keni parasysh që kjo është data 30 dhjetor 1998. C-ja
25 thotë Komisioni për Caktimin e Vijave Kufizuese të Zonave

1 Operative. Siç mund ta shohim, këtu përmendet i Sali Veselit,
2 pastaj "Shërbimi i Zbulimit" por në kllapa thotë (Zëvendës) si
3 dhe mbyllet kllapa, brenda dy kllapave më saktë -- më falni,
4 thuhet (Zëvendësi i Kadriut) megjithatë askush nuk duket se e
5 di kush është zëvendësi i Kadriut, sepse emrat e tjerë janë
6 dhënë po jo emri i zëvendësit. Dhe shohim që është bërë një
7 shkarravine në krah tek emri Luli. Është dhe prefiksi i
8 Zvicrës këtu në një numër telefoni.

9 Tani nëse ai nuk ka pasur zëvendës, sepse qartazi askush
10 nuk e di kush paska qenë ky zëvendës, juve a ju kujtohet
11 diskutimi që është bërë në këtë takim edhe dikush të këtë
12 thënë të thërrasim në telefon z. Veseli në Zvicër për ta
13 pyetur kush është zëvendësi i tij dhe a ka një zëvendës?

14 PË. Po. Takimi më kujtohet shumë mirë, por duhet t'i sqarojmë
15 mirë çështjet. Më parë tha që nuk është formu komisioni
16 kadrovik. Jo, komisioni kadrovik është formuar po nuk është
17 formuar komisioni i gradimit. Të jemi të kuartë me deklaratën
18 time të mëhershme për këto.

19 PY. Kërkoj ndjesë për këtë.

20 PY. E dyta, është e vërtetë kjo që po shkrun këtu. Që,
21 domethënë, në këtë komision të kufizimit të zonave ose kufijve
22 e zonave që të shkruhet edhe na shefi, faktikisht i zbulimit
23 dhe kundërzbulimit, zëvendësi i Kadrisë, nuk ka pas zëvendës.
24 Për q'atë është ashtu në kllapa, po nuk u dit. Numri është i
25 Lulit sigurisht në atë kohë prefiksit që e ka pas Kadri

1 Veseli. Por unë nuk kam bisedu me atë çështje me kërku se kush
2 është, e kush nuk e di. Unë nuk mbaj mend kush e ka pas këtë
3 numër edhe kush ka diskutuar. A ka kërku zëvendësin a jo.
4 Kështu që, po, shumë mirë më kujtohet takimi aty.

5 PY. Kjo ishte shumë e dobishme. E dimë që është numër
6 telefoni zviceran. Ju ndihmon ky informacion që ju dhashë i
7 kujt mund të jetë ky numër?

8 PË. Shumë saktë po shifet në shkresë numri është zviceran dhe
9 përfundi shkrun Luli. Kështu që është e kjartë që mund me kanë
10 numri i tij prefiksi.

11 Z. EMMERSON: [Përkthim] Një çast, ju lutem. Tani --
12 kërkoj ndjesë, bëni pak durim sa të gjej ku kam bërë shënimin
13 përkatës.

14 Disa nga pyetjet në fakt nuk do jenë sipas rendit
15 kronologjik, po do bëni pak durim.

16 Le të shohim materialin 1D00029 me ET në fund. Ky është
17 një dokument që ua ka treguar Prokurorja. Ju lutem me të
18 njëjtën referencë dhe anglishtja po përfundon me ET në fund.
19 Nëse ju ndihmoj t'ju jap numrin SPOE00119161. Ky është numri
20 origjinal i dokumentit, nëse ju ndihmon që të gjeni
21 dokumentin.

22 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. A është
23 dokument i listës së Veselit apo në ndonjë palë tjetër?

24 Z. EMMERSON: [Përkthim] Është tek dokumentet e ZPS-së.

25 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Më vjen keq, por unë

1 vetëm shqipen mund të gjej nga ky dokument. Sidoqoftë po
2 përpiqem dhe një herë.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Mbase mund t'ju ndihmoj unë? Është
4 edhe në listën tonë të prezantimeve sepse e përdora unë te
5 kundërpyetjet e mia në anglisht.

6 Z. EMMERSON: [Përkthim] Pra, ky dokument është përdorur
7 dhe nga Prokuroria dhe nga Ekipi i Mbrojtjes së Thaçit.

8 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Jo, unë nuk e kam përdorur këtë
9 dokument që të jemi të qartë.

10 Z. EMMERSON: [Përkthim] Në rregull atëherë. Ju kërkoj
11 ndjesë.

12 Po më thonë që ndonëse Prokurorja nuk e ka përdorur
13 dokumentin gjatë pyetjeve, është një nga dokumentet që është
14 në listën e tyre të materialeve dhe ka numrin 216 në rendin e
15 prezantimeve.

16 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Materiali me numër 216
17 tek lista e Prokurorisë është materiali me numër SPOE00119161
18 deri në SPOE00011916-ET dhe është pranuar me numrin e provës
19 materiale P00741-ET.3.

20 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po ky është dokumenti.

21 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mesa kuptova unë ju
22 kërkuat materialin 1D00029?

23 Z. EMMERSON: [Përkthim] Iu bënë disa pyetje lidhur me
24 pikat nga 4 deri tek 7. Për procesverbal, kjo është urdhëresa
25 që mban datën 28 nëntor dhe e keni nënshkruar ju në cilësinë e

1 shefit të shtabit. Dhe në hyrje thuhet për masat që janë të
2 domosdoshme veçanërisht masat disiplinore edhe penale për
3 ndërprerjen e dukurive negative.

4 Pika 1 dhe 2, si dhe 3, janë masa parandaluese, ndërsa
5 pika 4, 5, 6 dhe 7 ose të paktën 6, flet për ndëshkimin. Pikën
6 1 nuk e trajtuam, po le të flasim dhe për këtë:

7 "Komandantët e [zonave] duhet të rrisin kontrollin duke
8 angazhuar anëtarët e komandës, komandot e policisë ushtarake
9 që të bëhet menjëherë ndërprerja e dukurive negative të
10 keqpërdorimit ndaj personave dhe pasurisë private".

11 Pika 2 thotë:

12 "Ndalohet angazhimi dhe mobilizimi i mjeteve materiale si
13 dhe konfiskimi pa urdhëresën ose pa lejen e komandantit të
14 [zonës] operative".

15 Treshi:

16 "Në të gjitha njësitë e UÇK-së të parandalohen sjelljet
17 jokorrekte ndaj popullatës civile".

18 E vijon më pas flet për masat disiplinore dhe penale, mes
19 të cilave përfshihet edhe përmendet këtu edhe sistemi i
20 gjykatave për të cilin na thatë po krijohet prej Sokol
21 Dobrunës.

22 Tani, ju dhatë përshkrimin tuaj të kolaboracionistëve nga
23 pikëpamja e zbulimit. Po nga komandantët e zonave a keni
24 mësuar ndonjëherë që të ketë pasur persona në zonat e tyre që
25 e shpërdoronin këtë përkufizim herë pas here?

1 PË. Po, ka pas ankesa.

2 PY. Kjo urdhëresë ka dalë me kërkesë të komandantëve të
3 zonave apo është lëshuar për t'ju dhënë atyre kompetencat që u
4 nevojiteshin për të ndërmarre hapa, pra, nismën e morët ju apo
5 e keni lëshuar me kërkesën e tyre këtë urdhëresë?

6 PË. Kjo urdhëresë e lëshuar së pari në bashkëpunim me
7 komandantin e përgjithshëm, faktikisht me dijeninë e tij. Një.
8 E dyta, ankesat kanë qenë edhe prej komandantëve të zonave,
9 kanë qenë edhe prej civilëve në ato zona, nga shumë drejtime
10 më kanë ardhur ankesat. Për atë dhe komandanti ka vendosë që
11 të shkohet në këtë urdhëresë dhe t'i dërgohet komandantëve të
12 zonave, një, që t'i disiplinonjë edhe komandantët edhe
13 ushtarët në sjellje me civilët dhe me veprimet e tyre,
14 normalisht edhe komandanti i zonës që të ketë autoritetin e
15 plotë të kontrollit që mos me hy edhe zonave tjera edhe
16 ushtarë tjerë në zonat e komandantëve ku nuk janë të zonës së
17 tyre me vepru apo me u sjellë jo korrekt ndaj civilëve.

18 Kjo ishte thelbi i kësaj urdhërese të cilën është dhe
19 shkruar në atë kohë.

20 PY. Ndër raportet që merrnit mund të merrnit, për shembull
21 dhe raporte apo informacione që një druvar, për shembull, mund
22 ta bënte këtë apo ndonjë civil që punonte për autoritet serbe
23 apo ndonjëherë këto bëheshin për inate personale, apo jo?

24 PË. Tani mundet me thënë të gjitha drejtimet duke marrë prej
25 asaj që dikush edhe ka pas ndërtime të qëllimshme që ka vepru

1 deri te atyre të cilët kanë vepru edhe mos shkakan edhe
2 autoritetet e tyre kanë përdorur faktikisht për çështje
3 personale dikur të mëhershme para lufte që ka pasun me dikën.
4 Këto ishin të gjitha, domethënë, drejtimet që është dhënë që
5 të ndalen ato dukuri. Edhe e fundit ishte që me këtë urdhër të
6 disiplinohen dhe veç ishim dhe faktikisht armëpushimin e
7 kishim dhe ishin kontaktet me bashkësinë ndërkombëtare për t'i
8 treguar se ne jemi një ushtri që shkojmë duke u disiplinuar
9 dhe një ushtri e cila qëllimin e saj e ka çlirimin e Kosovës
10 dhe kjo ishte me këto masa të tilla po disiplinohet kjo ushtri
11 dhe po ec drejt saj.

12 PY. Ama ajo që dimë ne me siguri është që në kohën që keni
13 lëshuar këtë urdhëresë, me përjashtim të një periudhe të
14 shkurtër në fillim të nëntorit, z. Veseli nuk ka qenë në
15 Kosovë as në shtator, as në tetor, as nga 19 nëntori dhe deri
16 në atë periudhën dy ditore që thoni ju që është kthyer në fund
17 të janarit, kështu?

18 Pra, nëse kishte persona që keqpërdornin termin
19 "kolaboracionist" ose keqtrajtonin personat që ishin të
20 ndaluar, kjo ishte diçka e autorizuar apo ishte diçka kjo që
21 kryej nga nën nivel të Shtabit të Përgjithshëm?

22 PË. Së pari, përgjigjem -- se kenë disa pyetje këtu. E para
23 është, po, e saktë është që z. Veseli nuk ka qenë në këtë
24 periudhë.

25 E dyta, është që janë veprue edhe këtu me këta

1 komandantët e zonave e kanë pas këtë përgjegjësi dhe brigadave
2 në zonat e veta që të veprojnë. Në nivel të shtabit ende s'ka
3 pas mundësi në këtë kohë që është shtu më vonë që mund të
4 merren masat me zhvillimin e sektorit juridik.

5 PY. Faleminderit. Ti kthehemi periudhës pak kohë pas
6 mbërritjes suaj.

7 A e keni ditur paraprakisht ju se njoftimi duhej bërë më
8 10 ose 11 qershor, pra, njoftimi se Jakup Krasniqi do të bëhej
9 zëdhënës, do bëhej më 10 ose më 11 qershor për UÇK-në? E keni
10 ditur paraprakisht ju këtë informacion? Më duket se ju thatë
11 që atë verë ju nuk kemi pasur ndonjë rol formal në Shtabin e
12 Përgjithshëm sepse keni mbërritur më 28 maj.

13 Po para mbërritjes tuaj e keni ditur ju që do bëhej
14 shpallja se Jakup Krasniqi do të bëhej zëdhënës apo u befasuat
15 kur e dëgjuat?

16 PË. Jo, nuk e kam ditur atë më herët se do të bëhet Jakup
17 Krasniqi. Por qysh në qershor, në qoftë se e keni përcjellur
18 deklaratën time, në qershor jam takuar në Likovc me z.
19 Krasniqi kur e ka marrë këtë detyrë. Atëhere e kam pa për herë
20 të parë, po nuk më ka kominuku njeri se çfarë detyre do ta
21 ketë. Tek pastaj kam dëgju që është zëdhënësi i shtabit
22 qendror i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

23 PY. Unë po fokusohem tek njoftimi publik që do të bëhej për
24 rolin e tij si zëdhënës. Ne dimë që është bërë më 10 në
25 Deklaratën Politike numër 3, por u qarkullua më datën 11. Unë

1 tani do t'ju them diçka që i kujtohet z. Veseli sa i takon
2 rrethanave sesi e keni mësuar ju këtë informacion dhe shihni
3 nëse ju ndihmon dhe ju.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emmerson,
5 më falni një çast. Se znj. Alagendra është ngritur në këmbë.

6 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Besoj se ka një gabim të
7 transkriptit në rreshtin 16, 17. Ai nuk tha "zëvendës i
8 shtabit të përgjithshëm". Z. Emmerson tha "Zëdhënësi". I lutem
9 stenografit ta korrigjojë.

10 Z. EMMERSON: [Përkthim]

11 PY. A thatë "zëvendës" apo thatë "zëdhënës"?

12 PË. Unë thashë shumë mirë "zëdhënës", jo zëvendës po
13 zëdhënës.

14 PY. Faleminderit. Këtu doja të fokusohesha dhe unë.

15 Faleminderit.

16 Tani do t'ju tregoj që i kujtohet konkretisht z. Veseli,
17 ju të dy bashkë keni qenë rrugës për të takuar Ramush
18 Haradinaj kur është bërë ky njoftim. Ju kujtohet të keni
19 shkuar të keni takuar z. Ramush Haradinaj në këtë periudhë
20 kohore me z. Veseli?

21 PË. Nuk më kujtohet. Mendoni në qershor, në fillim?

22 PY. Po. Përafërsisht rreth datës 10, 11, 12, në këto data.

23 PË. Jo, nuk më kujtohet.

24 PY. A ju kujtohet një takim me Ramush Haradinaj ku ai reagoj
25 relativisht keq për faktin që ishte emëruar Jakup Krasniqi si

1 zëdhënës?

2 PË. Po, ky takim ka qenë në korrik.

3 PY. Të kujtohet një takim në Zhabel?

4 PË. Po.

5 PY. Ky takim është jo ai takimi i Jabllanicës, është takim
6 tjetër, e saktë?

7 PË. Po.

8 PY. Takimi i Jabllanicës që keni përmendur ju ka qenë në
9 korrik?

10 PË. Po, e saktë.

11 PY. Do flasim pas pushimit për këtë takim. Po një takim i
12 mëhershëm në Zhabel me z. Haradinaj ku ai shpërtheu nga inati,
13 nga zemërimi sepse ky njoftim ishte bërë pa u konsultuar me
14 komandantët e zonave?

15 PË. Po, më kujtohet shpërthimi, po nuk më kujtohen datat bash
16 dhe koha.

17 Z. EMMERSON: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, është momenti
18 i përshtatshëm ky për të bërë pushimin?

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do
20 bëjmë dhjetë minuta pushim siç e kemi praktikë këtu.

21 Z. Zyrapi, mund ët dilni nga salla me Asistenten.

22 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë dhjetë
24 minuta pushim.

25 --- Seanca ndërpritet në orën 10.00

1 --- Seanca rifillon në orën 10.10

2 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Asistente
3 e sallës, ju lutem, shoqëroni dëshmitarin të hyjë në sallë.

4 [Dëshmitari vijon dëshminë]

5 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull, z.
6 Zyrapi. Z. Emmerson do të vijojë me pyetjet e tij.

7 Z. EMMERSON: [Përkthim]

8 PY. Dua t'i kthehem pyetjes që ua bëra pak më përpara. Emri
9 Skënder Salluka ju thotë diçka?

10 PË. Emni, po, por mbiemri diqysh nuk është -- si e pa ...

11 PY. Mbase e kam keqshqiptuar mbiemrin. A mund të më thoni
12 juve mbiemrin që unë po përpiqem mbase ta them?

13 PË. Skënder Sallauka, mendon.

14 PY. Sallauka. Sallauka, po. Skënder Sallauka, ju kujtohet që
15 ta keni vizituar, të keni shkuar pra, ta takoni Ramush
16 Haradinajn me Skënder Sallaukën si shofer dhe me z. Veseli
17 gjithashtu me ju?

18 PË. Po, më kujtohet.

19 PY. T'ju them edhe disa informacione të tjera. Mbase mund
20 t'ju ndihmojë që të kujtoni kohën. Z. Haradinaj po ankohej, do
21 të thosha, lidhur me faktin se ky informacion sapo ishte bërë
22 publik dhe atij nuk i ishte thënë paraprakisht, madje as nuk
23 ishte konsultuar, nuk e dinte pra, madje se kush ishte Jakup
24 Krasniqi apo përse i kishin dhënë këtë autoritet pikësëpari.
25 Kjo ju kujton diçka?

1 PË. Po.

2 PY. Dhe pati kërcënime sepse regjioni i Dukagjinit kishte një
3 rëndësi sa i takon logjistikës, mendoj, sepse ishte rruga
4 përmes të cilës hynin kontrabandë armët përmes Shqipërisë,
5 kështu?

6 PË. Po.

7 PY. Z. Haradinaj ka kërcënuar që ta bllokonte këtë rrugë të
8 logjistikës sepse ishte shumë i inatosur dhe kërkonte garanci
9 që z. Krasniqi ishte i njohur me Lahi Brahimaj, apo Samjlin,
10 kushëririn e z. Haradinaj, dhe pastaj gradualisht përmes
11 këtyre garancive ai u qetësua diçka.

12 PË. Po. Po, e saktë është.

13 PY. Dhe pas takimit, nëse ju ndihmoj që ta kujtoni - një
14 moment, ju lutem - ju e kaluat natën në atë zonë me z. Veseli
15 dhe pastaj u kthyet në Drenicë, në Negroc, në kohën kur ka
16 ndodhur intervista me shtypin e z. Krasniqi. Ju kujtohet që
17 keni qenë i pranishëm në incizimin me kamerave televizive,
18 pra, të z. Krasniqi, kur ai po e shpallte emërimin e tij në
19 Negroc?

20 PË. Po, më kujtohet në Negroc kam qenë.

21 PY. Tani ne e dimë që ky njoftim është bërë më datë 11 dhe
22 incizimi me kamera në Negroc ka ndodhur më 13 qershor. Këto
23 fakte të vërtetuara objektivisht mbase mund të ndihmojnë për
24 përcaktimin kohor. Më duket se ju e keni konfirmuar që z.
25 Haradinaj ishte shumë i inatosur se sapo e kishte marrë

1 lajmin.

2 PË. Po. Po, është e saktë.

3 PY. Të ndaloj pakëz këtu e t'ju pyes për herën e parë fare me
4 të cilën -- kur e keni takuar z. Haradinaj që s'ka ndodhur
5 fare në Kosovë, do të thosha në Tiranë, në prill. Ju kujtohet
6 që jeni njohur pra, që jeni takuar me z. Haradinaj në Tiranë
7 në prill?

8 PË. Po, po.

9 PY. Dhe ai nuk pranoi të fliste me ju. Ju tha që "Do flasim
10 kur të hymë në Kosovë. Nuk flas me njerëzit jashtë Kosovës".
11 Ju kujtohet kjo?

12 PË. Po e saktë është, ashtu është.

13 PY. Kur mbërriti [Sipas përkthimit] më datë 23 [Sipas
14 përkthimit] maj, ju ishit shumë i interesuar që të takoheshit
15 me atë për të treguar që ju ishit në Kosovë. A nuk është
16 kështu?

17 PË. Po, kështu është.

18 PY. Pra, edhe një herë duke pasur parasysh faktin se kjo
19 deklaratë u bë publike më 11 dhe incizimi, pra filmimi, ndodhi
20 më duket në Kleçkë më datë 13 -- në Negroc, më falni, thashë,
21 -- por ju, takimi që ju bëtë në Gllogjan me Ramush Haradinaj
22 duhet të ketë qenë me datë 11 ose 12. Atëherë duhet të ketë
23 qenë?

24 PË. Me siguri mund të jetë. Nuk më kujtohet data saktë.

25 PY. Dhe konfirmoni e keni kaluar natën në zonën e Dukagjinit?

1 PË. Po.

2 PY. Faleminderit. Dua të kaloj tani në nja dy pika të fundit.
3 Pikësëpari, në intervistën tuaj me ZPS-në - nuk është nevoja
4 ta nxjerrim në ekran, plus nuk është në listën e prezantimit -
5 juve ju është bërë pyetja dhe është në Pjesën 10, faqet 10 dhe
6 11. Pra, ju është bërë pyetja nëse ju kujtohet ndonjë rast kur
7 Kadri Veseli të ketë -- t'ju ketë thënë ndonjëherë për
8 kolaboracionist individ i cili ishte arrestuar po duhej
9 arrestuar dhe se ju t'i jeni përgjigjur se ai nuk kishte
10 arrestuar.

11 Ju lutem më konfirmoni edhe një herë këtu që nuk e keni
12 dëgjuar asnjëherë z. Veseli, në asnjë moment, që t'ju ketë
13 thënë për ndonjë kolaboracionist individ brenda në Kosovë?

14 PË. Po, saktë është. Ashtu është.

15 PY. Dhe ky pasazh, për ata që na ndjekin, shtjellohet më tej
16 në paragrafin 19 të Shënimit Përgatitor me disa hollësi të
17 tjera. Por, ky qëndrim mbetet po kështu, apo jo?

18 PË. Saktë.

19 PY. Faleminderit. Unë këto pyetje kisha.

20 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
21 Z. Roberts.

22 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.
23 Ju lutem, një moment.

24 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Patjetër.

25 Pyetje të palës tjetër nga z. Roberts:

1 Z. ROBERTS: [Përkthim]

2 PY. Mirëdita, z. Zyrapi. Më quajnë Geoff Roberts. Jam avokat
3 mbrojtës për z. Selimi. Kam pyetje që do t'i bëj sot dhe me
4 shumë gjasë edhe nesër. Ju u bëtë disa ditë që jepni dëshmi
5 kështu që shpresoj të jeni në gjendje të mirë shëndetësore
6 ende, por nëse keni nevojë për ndonjë pushim, lirisht mund të
7 më thoni.

8 Fillimisht për pyetjet e para, shumë prej tyre kanë të
9 bëjnë me dëshmi të mëparshme që ju keni dhënë. Shumë prej tyre
10 mund t'u përgjigjeni me "po" ose "jo" ose sigurisht mund të --
11 me "po" ose "jo" nëse nuk pajtoheni. Sigurisht shpresojmë që
12 t'i kalojmë shpejt e shpejt. Nëse bëj pyetje të paqarta më
13 kërkoni që t'jua ripërsëris ndryshe.

14 Shpresoj që isha i qartë.

15 PY. Mirëdita, po, kjartë.

16 PY. Do të përpiqem që të ndjek rendin kohor të paktën tani në
17 fillim në mënyrë që të jetë e lehtë edhe për ju për të
18 ndjekur.

19 Do ta filloja me këtë: Kur saktësisht keni shkuar në
20 Shqipëri në vitin 1998?

21 PË. Në cilin aspekt "shkuar", nga Kosova në Shqipëri apo ...

22 PY. Jo, aty ku ishit më përpara, kur keni mbërritur në
23 Shqipëri. Se keni mbërritur në Shqipëri diku nga marsi, po do
24 të doja të dija saktësisht se kur.

25 PË. Po në Shqipëri kam mbërri nga perëndimi në mars, diku ka

1 qenun mesi i marsit. Po datën saktë nuk mundem.

2 PY. Pa problem. Kur keni mbërritur në fillim në Shqipëri
3 përgjegjësia juaj ishte që të stërvitnit individët që vinin si
4 nga diaspora, pra nga vende të tjera, por edhe ata të cilët
5 dilnin nga Kosova në Shqipëri për trajnim apo stërvitje,
6 kështu?

7 PË. Po, e saktë.

8 PY. Dhe shpesh kjo ishte stërvitje për persona të cilët nuk
9 kishin kurrfarë përgatitje ushtarake, pra s'e kishin kry
10 shërbimin ushtarak, kështu?

11 PË. Po, kjo është, ashtu është.

12 PY. Në fakt ata të cilët ju i keni stërvitur, ndonjëri prej
13 tyre e kishin kryer ndonjëherë shërbimin ushtarak në APJ, apo
14 jo?

15 PË. Zakonisht ata që janë trajnuar në Shqipëri kemi trajnu
16 ata që s'e kanë kry fare shërbimin ushtarak më herët.
17 Domethënë që s'kanë qenë në shërbimin ushtarak, s'kanë pas
18 njohuri asgjë me shërbime ushtarake.

19 PY. Për shkak të rrethanave asokohe ky trajnim të cilit ju e
20 mbanit zhvillohej vetëm pak javë, jo për muajt, e nevojshëm të
21 cilët normalisht do të duhej po të ishte një ushtri e
22 rregullt, apo jo?

23 PË. Po, saktë është.

24 PY. Përse ky trajnim zhvillohej vetëm për pak javë? Cila
25 është arsye pse nuk mund të zhvillohej për më gjatë?

1 PË. Nuk mund zhvillohej më gjatë për arsye -- për disa arsye:
2 e para është arsyeja se ne në atë kohë ende nuk kishin kurrëgjë
3 në Shqipëri të cilën do të mund të kishin bazat e stërvitjeve
4 që t'i kishim të gjitha resurset edhe mundësitë. Një. Duhet të
5 punohet më shumë në mënyrën ilegale.

6 E dyta, ishte çështje për shkak se edhe mosqëndrimi shumë
7 i grupeve të njerëzve të cilët vinin nga perëndimi dhe
8 qëndronin dhe mund të binin në sy. Kështu që duhej sa ma
9 shpejt të trajnohen, të përgatiten dhe të kthehen ose të
10 dërgohen prapë në Kosovë. Këto ishin një ndër, them, arsytet të
11 cilat ne më së shumti po e shpejtonim që të ishte sa më shkurt
12 trajnimi më cilësor që të paktën ai të ketë njohuri në
13 përdorimin e armës dhe në lëvizjet bazike, taktike në terren.
14 PY. Pra, një trajnim shumë bazik, kishit gjithashtu synimin
15 për me i dërgu sa më shpejt në Kosovë, në mënyrë që të
16 zhvillonin luftën, pra, të fillonin luftimet me një fjalë, të
17 gjitha këta ishin vullnetarë, apo jo?

18 PË. Po, të gjithë.

19 PY. Dhe secili prej tyre mund të largohej nga trajnimi vetë
20 për t'u kthyer në vendin e tyre apo dikun tjetër po të
21 dëshironin?

22 PË. Po, është e kjartë.

23 PY. Ndonjëri prej tyre, disa njerëz, a e kanë bërë këtë? Për
24 shembull që e kanë fillu stërvitjen, pastaj kanë kuptu që
25 s'bënte kjo punë për ta, janë kthyer në shtëpi, kështu?

1 PË. Po, ka pas edhe të tillë.

2 PY. Dhe ju s'kishit në dorë -- ju s'kishit çfarë bënit nëse
3 dikush prej tyre e ndatë mendjen të kthehej në shtëpi, nuk
4 mund t'i ndalonit, s'e kishit këtë mundësi, apo jo?

5 PË. Jo, është vullneti i tij.

6 PY. A e dini përse janë kthyer në shtëpi të tyre?

7 PË. Po tash dikush nga aspekti shëndetësor. Dikush nuk ka
8 qëndruar. Nuk janë të gjithë të njëjtë. Vullneti mund të jetë,
9 mundësitë janë të tjera.

10 PY. Mbase ka pasur ndonjë merak prej atyre që kanë ardhë si
11 vullnetarë për trajnim, por nuk kanë gjetur armët që
12 shpresonin që të gjenin, apo qoftë edhe aspekte të tjera
13 logjistike të cilat kanë shpresuar që do t'i gjenin kur kanë
14 ardhë?

15 PË. Po. Ajo është që grupe të tjera ose kanë ardh për armatim
16 ose për pajisje dhe ato kanë pasë q'atë -- ça kanë mujt me
17 gjetun kanë gjetun, kanë marrë dhe janë kthy prapë në Kosovë.

18 PY. Por -- më kritikojnë përkthyesit që nuk po bëj pauzën e
19 nevojshme. Por, për të qenë të qartë, pra, kufizimet sa i
20 takon armëve që ju kishit dhe uniformat që ju i kishit
21 asokohe, i kishit këto kufizime, apo jo?

22 PË. Po, kufizimet kanë qenë të gjitha, jo vetëm të armëve dhe
23 të uniformave. Ne nuk kemi pas as armë as uniforma aq shumë që
24 mund të gjinden. Një pjesë të madhe kemi mund të gjejmë për
25 këmbësorinë në Shqipëri, por në pjesë të tjera kemi ble në

1 tërë shtetet të tjera të cilat, ku kemi mujt t'i gjejmë për
2 t'i blerë ato. Mirëpo, në gjithë ato mundësitë që kemi pasur
3 apet ka pasur kufizime si në transportin e tyre deri kanë
4 mbërrit në Shqipëri apo prej Shqipërisë deri brenda në Kosovë.

5 Po njashtu edhe mundësitë financiare në fillim nuk kanë
6 qenë bash të tillë që kemi mujt t'i blejmë ose t'i kemi armët
7 ato më të nevojshme të cilët duhet t'i ketë ushtari në terren.
8 PY. Për të qenë të qartë, këto kufizime të cilat ju i
9 përshkruat kanë vazhdu së paku gjer atëherë kur ju keni hyrë
10 në Kosovë më datë 28 maj, kështu?

11 PË. Po, ato kufizime kanë qenë në atë kohë derisa kemi hyrë
12 në Kosovë më shumë. Pastaj te ne ka pas edhe më tutje
13 kufizime, por më pak se [E pakuptueshme] kur kam shkuar.

14 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më falni një
15 moment. Më ka ngrirë transkripti në ekran.

16 Z. ROBERTS: [Përkthim] Po, patjetër.

17 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem, mund
18 t'i hidhni një sy? Vetëm në ekranin tim.

19 [Trupi Gjykses dhe Sekretari i Gjykatës
20 këshillohen]

21 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
22 vazhdoni.

23 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.
24 PY. Për të qenë i qartë, pra siç i thatë Trupit Gjykses në
25 çështjen Haradinaj, ju keni përgjegjësi për të kontrolluar

1 llojin dhe cilësinë e armëve. Kjo ishte një prej detyrave
2 tuaja apo jo, kur ndodheshit në Shqipëri në prill të vitit
3 1998?

4 PË. Po, saktë.

5 PY. Ka qenë një detyrë mjaft e rëndësishme ma merr mendja,
6 sepse nuk dëshironit që t'ju shisnin armë të cilat ishin me
7 defekt, le të themi, pra që nuk ishin të sakta. Mjafton me një
8 "po" ose "jo".

9 E shikoj që po lëvizni kokën, por duhet me zë.

10 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, kam
11 përshtypjen që po pret që të ndaloni ju pyetjen, të dëgjojë
12 edhe përkthimin, pastaj.

13 Z. ROBERTS: [Përkthim] Po, keni të drejtë.

14 DËSHMITARI: Po, kjartë është.

15 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ai po i ndjek
16 udhëzimet e mia më mirë sesa ju.

17 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk është i pari dhe jam i sigurt
18 që nuk është i fundit.

19 PY. Pra, ju bënit këto trajnime, përfshirë ju bënit dhe
20 kontrollin e armëve dhe i keni thënë edhe Trupit Gjykues në
21 çështjen Haradinaj dhe kishit rreth 300 rekrutë të cilët
22 kalonin, kanë kaluar, pra, asokohe, pra, nga periudha e mesit
23 të marsit deri në fund të majit. A është kështu që ju i keni
24 stërvitur?

25 PË. Po.

1 PY. Dhe këto detyra jua kanë dhënë përgjithësisht për shkak
2 të përvojës tuaj ushtarake në Bosnje, apo jo?

3 PË. Këto përgjegjësi mi kanë dhënë për shkak të përvojave,
4 edhe qëtë në Bosnje, por edhe shkollimit tim ushtarak që e kam
5 pas edhe ma herët në ish-armatën.

6 PY. Dëshiroj që të verifikoj me saktësi se çfarë është kjo.
7 Po me sa kuptoj, ju keni lindur në vitin 1962 në Suharekë.
8 Keni ndjekur shkollën ushtarake në Sarajevë në vitin 1977. A
9 nuk është kështu?

10 PË. Po, kështu është.

11 PY. Keni qëndruar pastaj në Sarajevë prej asaj periudhe deri
12 në vitin 1995, apo keni shku me jetu dikund tjetër?

13 PË. Deri në, domethënë Sarajevë, me shkollën e mesme
14 ushtarake, nga 1977 deri në 1981, prej 1981 deri në 1986 kam
15 punuar në Sarajevë, pastaj në akademinë ushtarake në Beograd,
16 prapë në Sarajevë. Jam kthy në të njëjtën njësi dhe kam vazhdu
17 deri në, faktikisht, fillimin e luftës në Bosnje. Pastaj më
18 mbajtën në armatën boshnjake dhe deri në vitin 1995, janar
19 1995, kam qenë në Bosnje ose në Sarajevë.

20 PY. Pra, në ushtrinë boshnjake çfarë pozite keni pasur?

21 PË. Në ushtrinë boshnjake kam pas pozitën e komandantit të
22 brigadës. Në fund, [e pakuptueshme] kam ushtru deri në [e
23 pakuptueshme] kam qenë edhe komandant i divizionit të
24 këmbësisë.

25 PY. Ky është divizioni i këmbësisë në Shtabin e

1 Përgjithshëm, apo më saktë në Shtabin Qendror të ushtrisë
2 boshnjake, kështu?

3 PË. Jo, kur folim divizioni, divizioni është në kuadër të
4 korp armatës të asaj kohe, korp, Armatës 7 të Ushtrisë
5 Boshnjake të Korpusit të 3-të, faktikisht, Korpusi i 7-të
6 mbasi u bo të armatës boshnjake në atë kohë.

7 PY. Por keni pasur përvojë dhe njohuri se si funksiononte
8 ushtria boshnjake, përfshirë këtu Shtabin e Përgjithshëm të
9 ushtrisë boshnjake në atë kohë, apo jo?

10 PË. Po.

11 PY. Do flasim më në thellësi më vonë për këtë, por në mars --
12 pra, deri në marsin 1998 kur dhe u kthyet në Shqipëri ju i
13 takon që keni jetuar rreth 20 vjet jashtë Kosovës duke filluar
14 nga 1977, apo jo?

15 PË. Po, saktë.

16 PY. Përpara se të shkonit në Shqipëri, keni njohur
17 personalisht anëtarë të tjerë të UÇK-së që jetonin në Kosovë
18 dhe luftonin për UÇK-në?

19 PË. Kam njoftur por jo në Kosovë që kanë jetue, por që kanë
20 jetu jashtë në perëndim.

21 PY. Në rregull. Në këtë fazë, më duket se keni thënë në
22 çështjen Haradinaj që në këtë pikë në prill 1998 nuk ke qenë
23 as në UÇK, as jashtë UÇK-së, por që kishin besim tek ju dhe ju
24 dhanë detyrën të kryenit trajtime, kështu?

25 PË. Po.

1 PY. Dhe qartazi, edhe inspektimi i armëve për të cilin folët
2 më herët ishte një nga detyrat tuaja? Ju keni qenë bashkë me
3 disa ushtarë të tjerë me përvojë në Shqipëri kur kthyet këto
4 aftësime, stërvitje, apo jo?

5 PË. Po.

6 PY. E di që mund të duket shumë e qartë, por ajo që keni bërë
7 ju ato dy muaj në thelb ishte shumë e rëndësishme, apo jo?

8 PË. Po.

9 PY. Nëse nuk do i kishit trajnuar këta persona, ata nuk do të
10 dinin se çfarë të bënë kur të hynin në Kosovë. A është një
11 përshkrim i drejtë?

12 PË. Po, shumë shkurt e kuartë.

13 PY. Keni përmendur shumë persona me të cilët keni qenë
14 asokohe. Besoj se thatë Kadri Kastrati, Kemal Shaqiri, Mahir
15 Hasani dhe Shaban Dragaj. Të gjithë këta persona kanë qenë
16 bashkë me ju në Shqipëri në atë kohë, apo jo?

17 PË. Jo, në atë kohë në Shqipëri nuk ka qenë Kemal Shaqiri dhe
18 Shaban Draga. Folim për periudhën mars, prill, maj. Kam pasur
19 Kadri Kastratin, ka qenë Agim Qelaj, ka qenë Binak Gashi, ka
20 qenë Mahir Hasani, ka qenë Hysni Ahmeti, Mensur Kasumi. Ky
21 grup ka qenun me të cilin ne kemi punuar, ne kemi bërë
22 trajnimet e ushtarëve të cilët, domethënë, ata të cilët kanë
23 ardhur edhe nga perëndimi edhe nga Kosova.

24 PY. I keni thënë ZPS-së, por e keni thënë dhe në deklaratat të
25 mëparshme që duhet të prisnit në Shqipëri përpara se të hynit

1 në Kosovë në fund të majit, kështu? Ju kujtohet?

2 PË. Po.

3 PY. Në çështjen Haradinaj keni thënë që ju duhej miratimi nga
4 Shtabi i Përgjithshëm, pra duhej miratimi nga Shtabi i
5 Përgjithshëm për ish-oficerët e armatës jugosllave përpara se
6 të hynit në Kosovë, kështu?

7 PË. Po. Kështu është.

8 PY. A ju është thënë shprehimisht ju kjo apo kjo është diçka
9 që e supozuat ju vetë? A dolët ju në këtë përfundim? Nga a
10 morët ju këtë informacion?

11 PË. Këto informacion e kanë dhënë atëherë prej anëtareve të
12 UÇK-së, njerëzit të cilët kanë qenë në Tiranë.

13 PY. Ky proces kërkonte kohë qartazi. U ankuat ju atëherë pse
14 po zgjat kaq shumë?

15 PË. Po, disa herë.

16 PY. Pra, ju ishit i interesuar që të hynit sa më shpejt në
17 Kosovë në mënyrë që të vendosnit në përdorim përvojën dhe
18 njohuritë tuaja, apo jo?

19 PË. Po, saktë.

20 PY. Ju lutem më ndihmoni me një sqarim, sepse u trajtua pak
21 më herët por nuk e kuptova përgjigjen. Në maj, e dinit ju që
22 do të shkonit për të punuar në atë që dikur quhej drejtoria
23 operative e Shtabit të Përgjithshëm? Pra, këtë e keni ditur që
24 kur ishit në Shqipëri apo është diçka që e mësuat më vonë?

25 PË. Jo, këto e kam ditur kur kam hyrë brenda.

1 PY. A ka mundësi pra, a e pranoni ju që ekzistonte mundësia
2 paraprakisht që ju do të bashkoheshit në Shtabin e
3 Përgjithshëm ndonëse nuk ishit informuar formalisht për këtë,
4 dhe prandaj ishte e nevojshme që të bëhej një proces i
5 figurës, i verifikimit të figurës suaj? A e pranoni këtë si
6 sugjerim nga ana ime?

7 PË. Po ishte periudhë në të cilët pritshim.

8 PY. Edhe qartazi, fakti që nuk kishit qenë 20 vjet në Kosovë
9 nënkuptonte që nuk i njihnit shumë persona atje dhe s'kishte
10 shumë persona që mund të jepnin informacione për ju. A mund të
11 jetë kjo e pranueshme?

12 PË. Po.

13 PY. Besoj se më 3 korrik ju thatë që Azem Sylja jua dha dritën
14 jeshile të hynit në Kosovë edhe ju dha udhëzime, kështu?

15 PË. Po.

16 PY. Çfarë udhëzimesh ju dha?

17 PË. Po në atë kohë kur folim për -- kur na dha udhëzimet na
18 tregojti që do të jenë anëtarët e shtabit, do të shkojmë në
19 shtab brenda në Kosovë, dhe të cilën pastaj, shtabi do të na
20 jep detyrat të cilat ne do të angazhohemi, të jemi
21 profesionistë e të tregojmë punën tonë edhe të punojmë së
22 bashku me ata djemtë të cilët janë brenda. Ishte shkurt,
23 kjartë, nuk ishte ndonjë diçka ndonjë udhëzim apo ndonjë
24 detyrë të veçantë që mund të na jep ose të [E pakuptueshme].

25 PY. E kuptoj. Që ta përfundonin këtë proces dhe që të hynit

- 1 në Kosovë. Ju u përgjigjët z. Emmerson atë rastin me z.
2 Haradinaj në prill 1998, bëhet fjalë për atë rastin kur thanë
3 "o hy në Kosovë ose ik". E thanë kështu, në këto terma. "O
4 hajde o zhduku", diçka e tillë. Kështu?
5 PË. Po, po, ashtu është.
6 PY. Sipas jush a tregonte kjo që kishte një zemërim nga
7 personat që ishin brenda në Kosovë dhe që luftonin. Ju kishit
8 vetë përvojë ushtarake edhe nuk po hynit dot në Kosovë në atë
9 kohë duke qenë -- edhe pse e kishit këtë përvojë ushtarake dhe
10 kjo kishte krijuar një lloj frustrimi. Ishte kjo përshtypja
11 juaj?
12 PË. Po, përshtypja ka qenë shumë e kjartë. Ne, përvoja, ishim
13 duke nejtur në Tiranë, kurse brenda për brenda veç kishin
14 fillu luftime edhe djemtë që ishin brenda kishin nevojë për
15 ndihmën tonë. Dhe normalisht ky frustrim është i arsyeshëm nga
16 ana jeme, të cilët ka qenë në atë kohë.
17 PY. Ata mezi po prisnin që ju të shkonit t'i ndihmonit, apo
18 jo?
19 PË. Po, saktë.
20 PY. Gjatë kësaj periudhe kohore, jua shpjeguat në fakt Trupit
21 Gjykues në çështjen Haradinaj e keni shpjeguar këtë, ju nuk
22 kishit ndonjë informacion konkret se çfarë po ndodhte me
23 luftimet në Kosovë. Dinit që kishte luftime por nuk dinit se
24 çfarë po ndodhte konkretisht, kështu?
25 PË. Po, kështu është.

1 PY. Është e drejtë të themi që ju në fakt nuk e dinit as
2 strukturën e forcave të UÇK-së, njësisive, pikave, përpara se të
3 hynit vetë në vend?

4 PË. Po, saktë është.

5 PY. Tani të flasim për periudhën kur hytë në Kosovë. Një
6 pjesë e kësaj u diskutua pak shkurtimisht, por do të duhet ta
7 diskutoj edhe unë, kështu që bëni durim.

8 Ju keni dhënë dëshmi edhe më herët në çështje të tjera
9 gjyqësore. Keni përshkruar në çështjen Limaj tek ish-Tribunali
10 i Hagës, si ka qenë situata në fund të 1998. E keni konfirmuar
11 këtë në çështjen Haradinaj.

12 Z. ROBERTS: [Përkthim] Për procesverbal bëhet fjalë për
13 transkriptin në çështjen Haradinaj 3275 deri në 3276.

14 PY. Këtu keni folur për zonën e Drenicës, të Dukagjinit, dhe
15 keni thënë se:

16 "Këto zona ishin duke u zhvilluar. Ende nuk ishin
17 zhvilluar plotësisht. Kishin pasur një lloj organizimi në
18 fshatra dhe po unifikonin komandën e zonës së Drenicës."

19 Pra, gradualisht kishin filluar strukturimin nga
20 pikëpamja ushtarake në kompani dhe njësi dhe ishin të lidhura
21 drejtpërsëdrejti me komandën e zonës.

22 Është e saktë?

23 PË. Po, e saktë.

24 PY. Në faqen e radhës të transkriptit 3277, ju keni thënë që:

25 "Kur mbërritët në qershor, zona ende nuk ishte zhvilluar

1 si zonë në vetvete. Kishte grupe të vetëorganizuar, shtabe
2 lokale, siç ishte rasti i Malishevës dhe nuk kishin organizim
3 shumë të lartë të nivelit ushtarak. Zona filloi të
4 strukturohej nga mesi i qershorit. Nuk më kujtohet saktësisht
5 data, por më kujtohet vizita që kam bërë në këto zona. Kam
6 parë shumë njësite të vetëorganizaura dhe njësi që nuk ishin
7 të unifikuara në një komandë.”

8 A ju kujtohet kjo dëshmi dhe a vlen ende kjo që keni
9 thënë:

10 PË. Po, saktë është dhe ashtu [E pakuptueshme].

11 PY. Gjithashtu keni folur për faktin se Drenica dhe Dukagjini
12 ishin disi më të avancuara, ndonëse me kufizimet e mëdha që
13 kishte ky zhvillim në vetvete, por edhe brenda këtyre zonave
14 UÇK-ja kishte një kontroll të kufizuar të territorit, apo jo?

15 PË. Po, saktë.

16 PY. Dhe besoj se ju e keni përshkruar për kolegët, ju keni
17 thënë “Kishte xhepa që kontrollonte në territor, por që nuk u
18 lidhën më vonë këto xhepa me njëri-tjetrin”. Kështu? Më fal -
19 “U përpoqën më vonë t'i lidhnin këto xhepa me njëri-tjetrin”,
20 kështu?

21 PË. Po, saktë.

22 PY. Përpara se të hynit në Kosovë, ju nuk i njihnit zonat
23 gjeografike të këtyre xhepave me saktësi, kështu?

24 PË. Po, saktë është.

25 PY. Që të jem i qartë, kjo ka qenë gjatë gjithë luftës, apo

1 jo? Kanë ekzistuar xhepa, zona të caktuara që i kontrollonte
2 UÇK-ja brenda secilës zonë -- jo, do ta bëj edhe një herë
3 pyetjen. Zonat mbulonin gjithë territorin e Kosovës, apo jo?

4 PË. Jo, zonat kanë pas ndarjen territoriale, por nuk kanë
5 mbulu gjithë territorin e Kosovës. Disa pjesë kanë mujt me i
6 pas kontroll. Pjesën më të madhe e kanë pasur kontroll forcat
7 serbe.

8 PY. Në rregull. Por edhe në zonat pamë në hartë, edhe -- pra,
9 dhe në zonat që kishin, vetëm në disa xhepa kishin kontroll të
10 plotë, apo jo?

11 PË. Po.

12 PY. Në këtë periudhë fillestare kur sapo mbërritur, keni
13 thënë në çështjen Haradinaj, është në transkript në faqen
14 3290, keni thënë "UÇK-ja nuk ishte një ushtri e mirëfilltë,
15 por ishte një ushtri në zhvillim e sipër".

16 PË. Po.

17 PY. Sa i takon operacioneve që nisi UÇK-ja në atë kohë. keni
18 shpjeguar për TPNJ-në ish-Traibunalin e Hagës pra, dhe e keni
19 konfirmuar në çështjen Haradinaj se ndonëse teorikisht
20 kërkohet miratimi nga Shtabi i Përgjithshëm për të filluar
21 operacione luftarake, në realitet kjo nuk ka ndodhur në asnjë
22 vend në Kosovë, kështu?

23 PË. Po, kështu është.

24 PY. A vijoi të ishte kështu situata përgjatë gjithë verës -
25 qershor, korrik, gusht, shtator dhe madje në tetor?

1 PË. Po.

2 PY. A mund të ketë vijuar kështu situata edhe mbas tetorit?

3 PË. Po, ka pas edhe mbas tetorit.

4 PY. Sa i takon komunikimeve ju e keni konfirmuar që nuk ka
5 ekzistuar komunikimi i rregullt mes Shtabit të Përgjithshëm
6 dhe komandantëve të zonave apo dhe niveleve më të ulëta nga
7 maji deri në shtator. Do t'ju citoj një pjesë të dëshmisë që
8 keni thënë në çështjen Haradinaj që të jem i qartë.

9 Z. ROBERTS: [Përkthim] Është e reflektuar në transkript
10 në faqen 3291. Ju keni thënë:

11 "Nga sa më kujtohet nga korriku e në vijim nuk ka pasur
12 komunikime të rregulltave mes shtabit dhe komandantëve të
13 zonave."

14 Kështu?

15 PË. Po, kështu është.

16 PY. Më pas në faqen tjetër, 3292, ju është bërë një pyetje:

17 "Në përgjithësi a mund të na konfirmoni nga fundi i majit
18 deri në shtator se nuk ka pasur komunikime të rregulltave mes
19 katër personave që thonin se ishin anëtarë të Shtabit të
20 Përgjithshëm dhe komandantëve të zonave dhe atyre që vepronin
21 në nivel më të ulët në mbrojtjen e fshatrave?"

22 Ju jeni përgjigjur:

23 "S'ka pasur takime të rregullta.

24 "PY. Dhe besoj se komunikimet në përgjithësi ishin të
25 vështira besoj mes katër këtyre personave dhe komandantëve."

1 Ju keni kërkuar të përsëritej pyetja dhe ju jeni
2 përgjigjur:

3 "Po, ka qenë shumë e vështirë të komunikohesh në atë
4 kohë."

5 A është ende kjo dëshmia juaj?

6 PË. Po.

7 PY. Në faqen tjetër të të njëjtës çështje, ju keni thënë, në
8 faqen 3293, ju keni thënë:

9 "Nuk ka funksionuar në kuptimin e mirëfilltë. Një ushtri
10 tradicionale, Shtabi i Përgjithshëm duhet të ketë mundësinë të
11 kontaktojë trupat dhe komandantët, por kjo ishte një ushtri që
12 ishte ende e paformuar dhe ishte ende në zhvillim e sipër, e
13 prandaj nuk ishte e mundur të bëhej kjo."

14 Qëndron ende kjo, apo jo?

15 PË. Po, qëndron.

16 PY. Që të jem i qartë, kur hytë në Kosovë fund maji, fillim
17 qershori, ekzistonin shumë shtabe lokale që vepronin në gjithë
18 Kosovën, apo jo?

19 PË. Po, saktë. Që ta kuptojmë çfarë ishin këto shtabe lokale.
20 Shpesh këto shtabe ishin nëpër fshatra, apo jo?

21 PË. Po.

22 PY. Edhe ishin -- edhe drejtoheshin nga një person nga fshati
23 që kishte një lloj autoriteti apo kishte aftësi bindëse, mund
24 të themi, brenda atij fshati për t'i bindur personat që të
25 merrnin armët, kështu?

1 PË. Po, saktë.

2 PY. Dhe nuk e ndjenin për detyrim që t'i raportnin ndokujt
3 tjetër, nga përvoja që kishit ju?

4 PË. Po, në atë kohë.

5 PY. A është e vërtetë që shumë shpesh kishin përvojë të
6 kufizuar ushtarake, njohuri ushtarake, sa i takon të paktën
7 veprimeve në luftë?

8 PË. Po, është e saktë.

9 PY. Në intervistën për ZPS-në i keni përshkruar këto shtabet
10 lokale kështu -- është në P1355.1, faqja 32 anglishtja, dhe
11 faqja 32 dhe 33 shqipja, e intervistës. Ju thatë:

12 "Më vonë vizitova edhe vende të tjera, shtabe të tjera,
13 rajone të tjera ku kishin shtabe lokale të pakoordinuara që
14 s'kishin lidhje me njëri-tjetrin dhe nuk kishin kontakt mes
15 njëri-tjetrit. Secili e quante veten komandant dhe besonte se
16 kishte epërsi mbi të tjerët."

17 A është e saktë? Është ende dëshmia juaj?

18 PË. Po, e saktë.

19 PY. Kjo ka ndodhur në shumicën e zonave që keni vizituar ju
20 në atë kohë?

21 PË. Po.

22 PY. Pra, që të jemi të qartë ka një dallim shumë të madh mes
23 organizimit të këtyre shtabeve, si kanë qenë këto shtabe, dhe
24 se si duhet të funksionojë një ushtri, apo një ushtri tamam
25 ushtarake, që ju e kishit parë vetë nga përvoja juaj në

1 Bosnje. Kishte një dallim shumë të madh, apo jo?

2 PË. Po, saktë është.

3 PY. Pak më vonë do të flasim edhe për rolin tuaj pas pushim,
4 për rolin që patët mbasi mbërritët. Por, ju duhet të

5 komunikoni me disa nga këto shtabe lokale gjatë udhëtimit

6 tuaj në Kosovë, udhëtimeve, kështu?

7 PË. Po, kështu.

8 PY. Edhe roli ishte që t'u jepni këshilla, ndihmë, apo jo?

9 PË. Po, ashtu është.

10 PY. Po që të jemi të qartë, në atë kohë ata nuk e kishin për
11 detyrim që të zbatonin ato që ju thonit ju, apo jo?

12 PË. Po, saktë është.

13 PY. Nëse ata mendonin që propozimi juaj ishte i mirë, dhe nga
14 përvoja juaj ata e ndiqnin këshillën tuaj, por ama detyrim nuk
15 e kishin, apo jo?

16 PË. Po.

17 Z. ROBERTS: [Përkthim] Të nderuar Kryegjykatës, po shoh
18 që ora është 11 pa dy minuta. Mbase është momenti më i mirë
19 për të bërë pushimin.

20 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do
21 të bëjmë gjysmë ore pushim tani. Mos flisni me askënd për
22 dëshminë tuaj jashtë sallës së gjyqit. Mund të dilni nga salla
23 tani.

24 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

25 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë gjysmë

1 ore pushim.

2 --- Pauza fillon në orën 10.59

3 --- Seanca rifillon në orën 11.30

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

5 Asistente e Sallës, shoqërojeni dëshmitarin të hyjë në sallë.

6 [Dëshmitari vijon dëshminë]

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Zyrapi, z.

8 Roberts do të vazhdojë me pyetjet e tij.

9 Z. Roberts, keni fjalën.

10 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

11 PY. Mirëdita, z. Zyrapi,

12 PË. Mirëdita.

13 PY. Mu para pushimit po flisnim për shtabet lokale. Dhe duket

14 se i konfirmuat kolegut tim, z. Misetic, dje ose pardje që,

15 pra plus edhe në dëshminë tuaj në çështjen Limaj, që brigadat

16 filluan që të formoheshin në gusht të 1998, dhe procesi vijoi

17 në shtator, tetor dhe nëntor. Thjesht për t'jua rikujtuar, më

18 falni. Pra, po shohim këtë periudhë kohore për t'ju orientuar.

19 Nuk do të marr shtabin e Lisit se e keni trajtuar tashmë me z.

20 Misetic, por keni, ju jeni në dijeni, apo jo, edhe për shtabin

21 lokal të Rahovecit?

22 PË. Po.

23 PY. Dhe, ky shtab është krijuar kur ju ndodheshit në

24 Shqipëri, kështu që ju nuk e dini procesin se si ishte krijuar

25 dhe nga kush, apo jo?

1 PË. Po, saktë.

2 PY. Po kështu i keni thënë Prokurorisë gjatë seancës
3 përgatitore se nuk e dinit se cila ishte lidhja midis këtij
4 shtabi lokal dhe Shtabit të Përgjithshëm, pra midis Drenocit
5 dhe Shtabit të Përgjithshëm, gjatë qershorit 1998, duke thënë
6 që përdorej nga anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm si pikë
7 tranziti për të hyrë dhe dalë nga Shqipëria. A nuk është
8 kështu? Është paragrafi 8 i dokumentit shënues për, të seancës
9 përgatitore numër 1.

10 PË. Po, saktë. Kështu e kam thanë.

11 PY. Po kështu i keni konfirmuar Prokurorisë që kur keni
12 ndaluar në Drenoc, keni qëndruar, më duket, tri ditë aty për
13 të ndihmuar strukturat për të punuar dhe për t'i dhënë
14 udhëzime Mahir Hasanit se si të ngrinte strukturën e një
15 batalioni dhe u pajtua, pra u ra dakord pastaj që z. Hasani,
16 dhe më duket edhe Isuf Gashi, do të qëndronin aty, apo jo?

17 PË. Po, Mahir Hasani dhe Binak Gashi, jo Isuf Gashi.

18 PY. Po, ju kërkoj ndjesë, Binak Gashi. Pasi ju vetë u larguat
19 dhe e latë aty z. Gashi dhe z. Hasani, a e kam të saktë nëse
20 them që ky shtab lokal në thelb vijoi që të funksiononte
21 përgjithësisht në mënyrë të pavarur gjatë gjithë pjesës tjetër
22 të qershorit, korrikut dhe gushtit?

23 PË. Po, qershorit e korrikut, po.

24 PY. Mirë. Kur keni mbërrit në Drenoc, ju thatë se keni takuar
25 Xhemë, z. Gashi, por nuk ia dinit pozitën asokohe, dhe e

1 mësuat më vonë se çfarë ishte kjo, apo jo?

2 PË. Po.

3 PY. Xhemë Gashi ka dalë në Shqipëri në një moment të caktuar
4 më vonë gjatë atij viti, ju kujtohet kjo?

5 PË. Po, mbas kësaj periudhe.

6 PY. Kur, ju kujtohet, kur ka ndodh?

7 PË. Kjo ka ndodh pas ofensivës, domethënë, thuj, diku ka qenë
8 shtator a, tetor a, të 1998.

9 PY. Kjo ka qenë para krijimit të brigadës në atë zonë?

10 PË. Brigada ka fillu të formohet diku gushtit, pas ofensivës
11 të parë dhe, domethënë, ka pas, domethënë, goditje të madhe
12 edhe të shtabet lokale, të gjitha që kanë qenë, dhe kanë fillu
13 pastaj ta bëjmë një riorganizim t'i bashkëngjit ato njësite
14 dhe shtabet dhe të bohet një brigadë. Atëherë ka fillue
15 mirëpo, nuk është përfunduar menjëheri dhe ka vazhdu pastaj
16 riorganizimi i saj dhe shtator a tetor, faktikisht, nëntor kur
17 janë, jemi kthyer, jemi kthyer prapë në Kosovë.

18 PY. E kam të drejtë që Xhemë Gashi, Xhemajl Gashi, nuk u bë
19 komandant i brigadës atëherë?

20 PË. Nuk më kujtohet, bash [E pakuptueshme].

21 PY. Do t'i kthehem kësaj rrugës së parë në Drenoc. Ju u
22 takuat më duket me Gani Paqarizin, por nuk e dinit se çfarë
23 roli apo funksioni luante asokohe, kështu i keni thënë ZPS-së,
24 kështu është?

25 PË. Po, kështu është. Saktë.

1 PY. E njëjta vlen edhe për Selim Krasniqit, më duket se e
2 keni takuar në një tjetër rrugë që keni -- që keni shku pra në
3 Drenoc, por sërish nuk e dinit as çfarë roli kishte asokohe,
4 kështu?

5 PË. Po, saktë.

6 PY. Dhe nuk jua kanë prezantuar me siguri, po flasim për
7 qershorin këtu, të 1998, si anëtar të policisë ushtarake, apo
8 jo?

9 PË. Jo, në atë kohë [E padëgjueshme] s'më kanë prezantuar.

10 PY. Po ishit ju në dijeni të ekzistencës së njësive të
11 policisë ushtarake në atë shtab lokal?

12 PË. Nëse më kujtohet, unë s'kam pa polici ushtarake në q'atë
13 periudhë, qershor kur kemi mbërri na. Ka qenë njësia e shtabit
14 lokal, njësitet kanë pasur dipon [fonetikisht] apo si, me thanë
15 kjo policia, po do me dallu diçka jo.

16 PY. Faleminderit. Tani të shohim një dokument që ju ju është
17 treguar gjatë intervistës me ZPS-në.

18 Z. ROBERTS: [Përkthim] Është numri P67, me numër ERN
19 SITF00437785 deri në SITF00437792, në anglisht dhe në shqip,
20 ju lutem.

21 PY. E di që kjo intervistë ka qenë para disa vjetësh, por nuk
22 e di a ju kujtohet që ta keni parë këtë dokument dhe të keni
23 folur për këtë gjatë intervistës suaj me ZPS-në?

24 PË. S'po më kujtohet.

25 PY. Mund të shohim intervistën tuaj me ZPS-në, mbase mund të

1 kalojmë në, edhe në faqen tjetër, në mënyrë që ta shihni në
2 ekran, dhe faqen e fundit gjithashtu për nënshkrimin, për të
3 pasur një ide të përgjithshme.

4 Jua ndihmon pak kujtesën që jua kanë treguar këtë
5 dokument gjatë intervistës suaj me ZPS-në?

6 PË. Po.

7 PY. Tani, që të jemi të qartë, ju thatë që në fillim se nuk e
8 dini se nënshkrimi i kujt është ky, dhe se nuk e keni marrë
9 kurrë, nuk e keni marrë këtë dokument përpara.

10 Z. ROBERTS: [Përkthim] Është me numër P03 -- ky është
11 procesverbali, pra, P11953 [Sipas përkthimit] faqet 8 dhe 10.

12 PY. A mund të konfirmoni që kjo është e vërtetë?

13 PË. Po, po. Saktë.

14 PY. Në intervistën tuaj me ZPS-në ju është bërë pyetje lidhur
15 me fjalinë e parë.

16 Z. ROBERTS: [Përkthim] Kështu që, ju lutem, i lutem
17 Sekretarit të kalojmë në faqen e parë të këtij dokumenti.

18 PY. Është paragrafi i dytë i tekstit që thuhet:

19 "Deri tani nuk i kemi dërguar asnjë raport këtij shtabi
20 (me përjashtim një që është kërkuar për rastin e Rahovecit)
21 ..."

22 Dhe ZPS-së ju i keni thënë lidhur me këtë rresht se nuk
23 keni parë kurrë një raport të mëparshëm nga Rahoveci nga
24 shtabi lokal i Rahovecit, dhe se nuk e kishit dijeni, pra, që
25 ishte përpiluar një raport i tillë.

1 Z. ROBERTS: [Përkthim] Është në provën materiale me numër
2 P11345 [Sipas përkthimit], më falni, 953 [Sipas përkthimit]
3 faqet 11.

4 PY. Ju kujtohet t'i keni thënë kështu ZPS-së?

5 PË. Po, saktë.

6 PY. Gjithashtu i keni thënë ZPS-së lidhur me Rahovecit,
7 shtabit lokal atje, se nuk keni marrë ndonjë raport tjetër të
8 mëpasshëm nga shtabi lokal i Rahovecit.

9 Dhe kjo është në intervistën tuaj me numër P1355.3, faqja
10 6.

11 Pra, kështu është, apo jo? Që nuk keni marrë asnjë raport
12 pas, më pas, pra nga Rahoveci.

13 PË. Po, saktë është.

14 Z. VANREUSEL: [Përkthim] Mund t'i kërkonit Avokatit që të
15 më tregojë se në cilën pjesë të ZPS-së po flasim? Sepse është
16 e vështirë për të ndjekur këtë.

17 Z. ROBERTS: [Përkthim] Po, kërkoj ndjesë, është Pjesa 3,
18 faqja 6. Unë e kam parasysh edhe udhëzimin e të nderuarit
19 Gjykatës. Do të përpiqem ta jap dhe më vonë këtë.

20 PY. Tani, që të jem i qartë, z. Zyrapi, e kam kuptuar qartë
21 se ju keni thënë në dëshminë tuaj se nuk keni marrë asnjëherë
22 një raport të mëparshëm nga shtabi lokal i Rahovecit dhe as
23 këtë raport nuk e keni marrë kurrë nga shtabi lokal i
24 Rahovecit, kështu është?

25 PË. Po, kështu është.

1 PY. Ky raport, në faqen e fundit mban datën 15 gusht 1998.
2 Dhe keni konfirmuar, sigurisht, disa herë Trupit Gjykues, ju
3 kanë emëruar si shef të departamentit të operacioneve, rreth
4 15 korrikut, pra para një muaji, apo jo?

5 PË. Po, ashtu diku.

6 PY. Në këtë pozitë që kishit, po t'jua kishin dërguar këtë
7 dokument, normalisht duhet ta kishit marrë, apo jo?

8 PË. Po, saktë.

9 PY. Ju kujtohet informacioni që përmban ky dokument? Pa shumë
10 hollësi, se kuptoj që jua kanë treguar para disa vjetësh.

11 PË. Po, më kanë treguar disa vite këto, këtë dokument, mirëpo
12 po të ishte një raport i tillë, do ta kisha ndërmend dhe do ta
13 kisha ditur për to. Në atë kohë kur folim për kohën e
14 korrikut, gushtit, ishte veç ofensivat serbe, dhe ne nuk
15 kishim kohë dhe të mirremi me këto çështje ose të merremi me
16 raporte, ose të dërgonim raporte.

17 E dyta, që i përket kësaj, sa -- shtabi lokal i
18 Rahovecit, dhe në atë kohë ishte dhe apert pasi këtij sulmi që
19 ishte në atë kohë, se këtu kanë qenë së pari dy shtabe. Nji
20 shtab ka qenë në Drenoc dhe shtabi tjetër ka qenë në Rahovec.
21 Dhe asnjëri me tjetrin nuk kanë pas koordinim. Për atë edhe ka
22 ndodh ajo që ka ndodh në Rahovec në korrik.

23 Po këtu folet për një shtab lokal operativ me përgjegjësi
24 për Rahovecin -- nuk po më korrespondon me kohën edhe momentin
25 që ka ndodh në atë kohë. Edhe qysh ka shkue, qysh është

1 zhvillue. Për atë nuk kam pas kësi raporti në atë kohë, edhe
2 nuk po mundem ta korrespondoj ose ta krahasoj me kohën e
3 atëherit kur kanë ndodh këto raste.

4 PY. Faleminderit. Sa i takon vetë raportit, në këtë paragraf
5 të dytë, duket -- dhe do ta lexoj:

6 "Prandaj duke e ndier veten përgjegjës për vonesën e
7 këtij raporti, përmes këtij po ju dërgojmë të dhëna, ca të
8 dhëna për punën që ka bërë njësitit ynë gjatë kësaj kohe."

9 E shihni këtë fjali në paragrafin e dytë?

10 PË. Po.

11 PY. Pra, duket shumë qartë që ky nuk është një raport që
12 është kërkuar nga ju, apo nga anëtarët e tjerë të Shtabit të
13 Përgjithshëm, apo jo?

14 PË. Po, saktë.

15 PY. Dhe siç e shpjeguat, para disa çastesh, ishte koha që veç
16 kishte filluar ofensiva e rëndë e ashpër serbe, pra nuk është
17 se do të merreshit, pra nuk do të, nuk ishte kjo ajo që do
18 kërkonit, se kishit gjëra shumë më të rëndësishme për të bërë,
19 nëse mund ta them kështu.

20 PË. Po, po, saktë.

21 PY. Por, duke pasur parasysh përmbajtjen e këtij raporti, dhe
22 këtu vijohet të shpjegohet një përshkrim i detyrave dhe
23 përgjegjësive të personelit të këtyre individëve, ky
24 informacion duket se i është dhënë Shtabit të Përgjithshëm a
25 thua se këta nuk ishin fare në dijeni të kësaj? Ka kuptim kjo?

1 Ose mund ta them ndryshe pyetjen.

2 PË. Ma thoni pak ma ndryshe, nuk...

3 PY. Patjetër. Pra, kështu siç e lexojmë, duket se është një
4 shpjegim i detyrave, personelit, të individëve, të detyrave,
5 të shtabit lokal operativ të Rahovecit nga prilli i vitit
6 1998, deri në 15 gusht të vitit 1998. Pra, nga 28 prilli deri
7 më 15 gusht.

8 Pra, pyetja që po them, që kam unë është kjo, që ky
9 informacion jepet këtu a thua sikur për këtë nuk kishte fare
10 dijeni Shtabi i Përgjithshëm. Pra, që nuk kishin dijeni për
11 këtë informacion përpara përpilimit të këtij raporti.

12 PË. Është e saktë që ne nuk e, domethënë këtë raport thuhet
13 që, këtu shënohet që veprimtaria e këtij shtabi prej krijimit
14 kur u ka formuar ky shtab, deri në gusht. Mirëpo ne si
15 pikëpari duhet të kemi të kuartë ato, këtu është raporti i
16 qershorit, edhe thuhet "Shtabi i Përgjithshëm". Në atë kohë
17 nuk është qujt Shtabi i Përgjithshëm është qujt Shtabi
18 Qendror. Domethënë nuk përputhet asnjëherë me formacionin
19 ekzistues të asaj kohës. E tash nuk është që ka bo një raport
20 të tillë të cilin ka dasht të raportohen ose të shkruhen se si
21 u zhvillu ky shtab ose çka ka vepru ky shtab. Por kjo, ky
22 dokument nuk ka ardh në shtab dhe ne asnjëherë nuk e kemi
23 kërku se s'kemi pas kohë të kërkojmë këto, për këto çështje.
24 Dhe kështu që nuk di çka të komentoj në këtë, domethënë një
25 raport të cilin as e kemi kërku edhe as e kam pas në dorë.

1 PY. E kuptoj. Nuk do të bëj pyetje të tjera lidhur me këtë.

2 Në lidhje me Binak Gashin, ju e cekët apo korrigjuat që
3 ai mbeti në Drenoc kur kaluat aty, sepse fillim -- ai ishte
4 nga zona e Gremnikut, pra aty kish lindur dhe i njihte
5 njerëzit aty, prandaj dhe u la aty, qëndroi aty që të jepte
6 ndihmë shtabit lokal të Rahovecit. A nuk është kështu?

7 PË. Po, saktë.

8 PY. Nuk ndodhte shpesh kjo gjë që kur njerëzit hynin në
9 Kosovë shkonin ose zona që i njihnin, ose qëndronin në ato
10 zona sepse aty mund të ishin më produktive dhe të ndërtonin
11 marrëdhëniet e nevojshme në ato zona?

12 PË. Po, në përgjithësi ka qenë.

13 PY. Në lidhje me z. Gashi, ma merr mendja se ishte dëshira
14 apo kërkesa e tij për të qëndruar në Drenoc, mund ta themi
15 kështu?

16 PË. Po. Për shkak se ishte i territorit, unë e ceka dhe
17 atëherë është i Gremnikut, dhe i ka njoft ata, dhe ka njoft
18 edhe ai territorin, dhe njerëzit e kanë njoft. Dhe ka pas një
19 autoritet te ta.

20 PY. Po, ishte dëshira e tij për qëndruar aty, siç edhe mund
21 të kishte sugjeruar çdokush tjetër që duhet të qëndronte atje?

22 PË. Po, saktë.

23 PY. Kalojmë tani në temën tjetër. Që është drejtoria
24 operative e Shtabit Qendror që më pas u bë Shtabi i
25 Përgjithshëm dhe çfarë roli kishte saktësisht kur ju keni hy

1 në Kosovë në qershor të vitit 1998.

2 E keni fillu punën në këtë, në këtë drejtori të
3 operacioneve kur keni mbërrit, kështu?

4 PË. Po.

5 PY. Dhe më herët kemi dëgjuar për rolet tuaja të ndryshme
6 pranë ushtrisë boshnjake kur keni punuar aty nga viti 1992
7 deri 1995. Po përpiqem të kuptoj se cili ishte roli i këtij
8 departamenti apo drejtorie operative, dhe si mund të
9 krahasohet kjo, ku qëndron kjo në krahasim, në raport me atë
10 të parën.

11 Më duket se e keni më përpara, mos gaboj, që ju keni qenë
12 në Korpusin e 7 si shef i këmbësorisë, flas për armatën
13 boshnjake, më falni.

14 PË. Po.

15 PY. Por siç e keni konfirmuar, ju kishit njohuri dhe përvojë
16 të shtabit kryesor të armatës boshnjake?

17 PË. Po.

18 PY. Cili do të ishte ekuivalenti i drejtorisë operative pranë
19 kësaj armate boshnjake në vitin 1993, fjala bie?

20 PË. Po, në vitin 1993, veç drejtorisë apo sektori i tillë i
21 operativës në Shtabin Suprem të armatës boshnjake, ose Shtabi
22 i Përgjithshëm, them, ushtrie, është në atë kohë veç ka qenë e
23 plotësime, se situata ndryshe ka qenë në Bosnjë, ndryshe në
24 Kosovë. Se në Bosnjë kemi pas shumë eprorë ushtarakë se edhe
25 ne kemi qenë në ish-armatën jugosllave. Si ne pat edhe

1 boshnjakë të tjerë, dhe këtë drejtori e kanë përbërë të gjithë
2 eprorët ushtarakë me përvoja të cilat i kanë pasur
3 jashtëzakonisht të mëdhaja, të cilët i kanë udhëhequr njësitet
4 operative strategjike ma herët. Dhe ato kanë, janë vendosur
5 pastaj në këtë drejtori ose në këtë sektor.

6 Dhe në këtë sektor zakonisht nuk është veç një epror i
7 përgjithshëm, por janë eprorë të gjitha lëmive, edhe
8 profesioneve ushtarake, të cilët përbëjnë këtë sektor, në të
9 cilën marrin vendime për përdorimin e njësive si në mbrojtje,
10 si në sulm, si në përgatitjen e njësive. Faktikisht, ky sektor
11 është i cili bën operacionalizimin e një ushtrie që të është e
12 gatshme operationale në veprimin e saj, në fund për çka është,
13 e ka detyrën dhe misionin.

14 PY. Pra, e thënë thjesht, është një prej drejtorive më të
15 rëndësishme të një ushtrie, apo jo, të një ushtrie të rregullt
16 siç ishte ajo e Bosnjës?

17 PË. Po, saktë.

18 PY. Kur thoni se kishte, pra që kjo "përbëhej nga oficerë me
19 përvojë shumë të madhe", për sa njerëz po flasim këtu, e kam
20 fjalën për ushtrinë boshnjake asokohe?

21 PË. Po në [E pakuptueshme] sektori i operativës në atë kohë
22 ka përbërë diku domethënë oficerë të karrierës, ka pasur
23 dikund me thënë 50 apo 60 oficerë të ndryshëm, në sektorët e
24 saj.

25 PY. Më fal që ju ndërpres. Pra janë 50 deri në 60 individë me

1 përvojë të gjerë ushtarake të cilët janë stërvitur për këtë
2 rol për shumë e shumë vite. Me çfarë grade ishin këta
3 individë?

4 PË. Zakonisht. Po. Zakonisht në këtë pozicion, do të thotë
5 pozicione janë eprorë që kanë përvoja, janë ata prej gradës të
6 majorit e deri te grada e gjeneralit që udhëheq sektorin e
7 operativës.

8 PY. Ma merr mendja që -- kishin edhe mbështetje të
9 gjerësishme administrative për punën e tyre, apo jo?

10 PË. Po, plotësisht.

11 PY. Pra, pa u kufizuar te kjo, ata kishin dhe zyrat e tyre,
12 komandën e tyre, ma merr mendja?

13 PË. Po. Çdo sektor, ato kanë zyrat e tyre, kanë sallat
14 operative, kanë zyrat për çdo sektor, në çdo drejtim që
15 ekziston në ushtri.

16 PY. Dhe besoj se kishit edhe pajisje të gjerësishme të
17 ndërlydhjes. E kam fjalën për shembull për ushtrinë boshnjake,
18 në vitet 1993 kishit pajisje të ndërlydhjes të cilat ju jepnin
19 mundësi që të lidheshit me të gjitha njësitet në mbarë vendin,
20 apo jo?

21 PË. Po.

22 PY. Dhe harta të hollësishme, me hollësi për terrenin,
23 topografinë, vendndodhjen, si të forcave tuaja ashtu dhe të
24 forcave armike, ma merr mendja me hollësi të konsiderueshme,
25 apo jo?

1 PË. Po, saktë.

2 PY. Nëse do ta krahasojmë tani këtë me Kosovën e fillimit të
3 qershorit të 1998. Siç e kuptoj unë, asokohe ju kishit disa
4 grupe luftëtarësh të vendosur në ato që ju i quanit "pika",
5 apo jo?

6 PË. Po, e saktë.

7 PY. Dhe sigurisht, nuk kishit një komandë me seli fikse me të
8 gjitha këto shërbime që përmenda. Pra, me pajisje, me hartat,
9 për gjithë Kosovën, asnjë prej këtyre hartave pra, s'kishit
10 një ide reale, specifike, të vendndodhjes së sasisë së forcave
11 në mbarë vendin.

12 PË. Po, saktë.

13 PY. Që të jemi të drejtë, që ta quash këtë sektor apo subjekt
14 drejtori operative, është pak e ekzagjeruar, apo jo?

15 PË. Po, për atë kohë.

16 PY. Po, për atë kohë. Flasim nga qershori deri në momentin që
17 ju u bëtë shefi i operatives, rreth 15 korrikut. Në këtë
18 periudhë kohore i kam të fokusuara pyetjet.

19 Që të jemi të qartë, drejtoria operative në atë kohë,
20 përbëhej nga z. Selimi, z. Bashota, ju personalisht dhe z.
21 Qelaj, apo jo? E thashë drejt? Agim Qelaj e kisha fjalën.

22 PË. Po, saktë.

23 PY. Roli juaj, i të katërve jush, ishte të shihnit shtabet e
24 ndryshme në, lokal, të kuptonit çfarë përbërje, kishin çfarë
25 burimesh kishin, dhe t'i ndihmonit dhe të këshillonit sikurse

1 na e thatë ju vetë.

2 PË. Po, saktë.

3 PY. A -- a pati ndonjë ndryshim rrënjësor pas 15 korrikut? A
4 bëri ndonjë ndryshim rrënjësor në këtë periudhë 6 javore pas
5 15 korrikut, apo në thelb ishte i njëjti numër personash, dhe
6 ju patët të njëjtin rol derisa e morët tërësisht detyrën?

7 PË. Po, saktë. Nuk pati diçka ndryshime më tutje se për arsye
8 se kur folëm 15 korrikut, pastaj filloi veç ofensivat serbe,
9 filloi Rahovecit, gjithë ato, dhe nuk kemi pas mundësi ma as
10 ta zhvillojmë këtë drejtori, por sa kemi mujt [E pakuptueshme]
11 tonë dhe mundësitë tona, faktikisht, ne katër kemi ngajtur
12 nëpër zonat për t'i ndihmuar shtabeve të asaj kohe të zonave,
13 nënzonave, edhe shtabeve lokale.

14 PY. Po. Që të jem i qartë, pyetjet nuk i kam absolutisht si
15 kritikë për punën që keni bërë ju asokohe. Thjesht po përpiqem
16 të jap një panoramë të situatës në Kosovë dhe si ka qenë
17 situata për ju dhe kolegët tuaj në drejtorinë ku punonit.

18 Tani, i keni thënë Trupit Gjykses në çështjen
19 Milutinovic, është në faqen, është në provën materiale P1356
20 për procesverbal, pra ku keni thënë se UÇK-ja kontrollonte
21 rreth 50 për qind të territorit të Kosovës, në mes të
22 korrikut, kështu? Flasim për periudhën e mesit të korrikut.

23 PË. Diku mesit të korrikut, në qoftë se marrim pjesën
24 qendrore, gati thuaj Drenica ishte pjesën më e madhe në
25 kontrollin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pjesa e

1 Pashtrikut një pjesë, domethënë kur merrshim me to, mund të
2 jetë e ekzagjeruar përqindja, por ishte një pjesë e madhe e
3 kontrollit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

4 PY. Mund të ketë qenë dhe 30, 40 për qind, dhe kjo është një
5 përshkrim i saktë, realist, apo jo?

6 PË. Po.

7 PY. Ju përmendët ofensivën e verës para një çasti, pas
8 Rahovecit, pas kësaj ofensive ka qenë shumë e vështirë për
9 njësitë e UÇK-së t'i mbronin këto territore, apo jo?

10 PË. Po, me fillimin e ofensivës domethënë ka qenë problem
11 shumë, se edhe të mbron këto territore, por dhe të mban ato
12 njësi lokale që të cilët ishin formuar.

13 PY. Po pse ishte kaq e vështirë?

14 PË. Vështirë ishte se së pikëpari ne e shpjeguam edhe më
15 herët, nuk ishte sistemi i organizuar hala ushtarak, ishin
16 hala shtabet lokale, ishin hala në formimet e fillimit, pak,
17 faktikisht, fillim edhe ristrukturimin edhe në brigada, por që
18 nuk arritëm. Dhe sulmet të cilat u bënë nga forcat serbe.

19 Resurset nuk ishin të mjaftueshme për këtë drejtim të shkohet
20 aq shpejt. Normalisht që nuk mujtëm të arritëm të bëhet kjo.

21 Për atë edhe këto ishin arsyet të cilat ne, i kam cekur dhe ma
22 herët.

23 PY. Po. Pra, ndonëse kishin kontroll të territorit, ishte
24 shumë i dobët ky kontroll. Kështu që kur sulmoi armata

25 jugosllave, forcat jugosllave, ishte shumë e vështirë që të

1 mbroheshit kundër tyre. Sidoqoftë, në këtë periudhë gjashtë
2 javore nga fillimi i qershorit, dhe deri nga mesi i korrikut,
3 ju jeni përpjekur t'i forconi pozicionet mbrojtëse, apo jo?
4 PË. Po.

5 PY. Prisnit ju ndonjë sulm nga ushtria jugosllave? Ishte
6 diçka që nga këndvështrimi ushtarak do të ndodhte, e prisnit
7 diçka të tillë, e nuhasnit?

8 PË. Po ajo është çka ndodhur prej fillimit të Rahovecit, e të
9 tjerë, që kanë ndodhur sulmet e ushtrisë edhe serbe, edhe
10 forcave policore. Kemi pas sulme të pandalme prej asaj kohe e
11 deri në tetor.

12 PY. Po, por para Rahovecit, para Rahovecit, kur shkuat në
13 Kosovë, në atë periudhën gjashtë javore nga fillimi i
14 qershorit deri në mes korrikut, ju e prisnit një sulm, prisnit
15 që forcat jugosllave të nisnin një sulm kundër UÇK-së?

16 PË. Ne edhe më herët, kur kam shpjeguar, treguar, se zona dhe
17 e Drenicës dhe e Dukagjinit kanë qenë aktive. Kur them
18 "aktive" kanë qenë në aspektin e luftës, luftarake, se
19 gjithnjë ka pas sulme të forcave serbe në këto territore. Për
20 atë edhe kështu që gjithnjë është pritur dhe gjithnjë kanë, e
21 përgatitet, është dasht të bëhen për mbrojtjen e këtyre
22 territoreve.

23 PY. Po. Se unë po përpiqem të kuptoj këtë. Ku ka qenë fokusi
24 i drejtorisë operative, dhe unë do sugjeroja që ju në atë kohë
25 fokusin e kishit kryesisht të këshillonit njësitë që vizitonit

1 që të dinin si të mbroheshin në rast se forcat serbe do të
2 nisnin një sulm. A është e një përshkrim i drejtë?

3 PË. Po, është shkurt, kjartë, është kjo.

4 PY. Tani, sa u takon operacioneve që kanë ndodhur në atë
5 kohë, i vetmi operacion që me sa kuptoj unë ka ndodhur, ka
6 qenë në luftimet në minierën e [Shënim i përkthyesit:
7 Përkthyesi s'e kupton emrin e fshatit Belecevac], ju keni qenë
8 që keni shkuar në Belecevac kur kishte mbaruar çdo gjë, në
9 fund. Dhe nuk ju kujtohet shumë se çfarë ka ndodhur.

10 Z. ROBERTS: [Përkthim] Kjo është pjesë e intervistës që
11 keni dhënë për ZPS-në, Pjesa 2, faqja 20, prova materiale
12 P1355.2.

13 PY. Kështu pra, nuk ju kujtohet shumë për këtë sulm në këtë
14 minierë të Belecevacit, fshati nuk jemi të sigurt për
15 shqiptimin.

16 PË. Shqiptimi i emrit të fshatit është Belaçevc. Është një
17 minierë sipërfaqësore. Është e saktë, e më kujtohet kjo kur ka
18 ndodh edhe kur kam shkuar atje. Po, saktë është.

19 PY. Ju kërkojmë ndjesë për shqiptimin. Po ashtu i keni thënë
20 ZPS-së, ja sa të gjej një çast referencën, në Pjesën 2, faqja
21 22, intervista për ZPS-në, edhe një herë është prova P1355.2.
22 Ju thatë që kur mbërritët, zëvendëskomandanti i zonës
23 operative të Shalës të tha cilat njësi kishin marrë pjesë. Dhe
24 sipas asaj që ju tha ai, sulmi u drejtua nga komandanti i
25 njësisë, emri nuk ju kujtohet tani, ka qenë një njësi e vogël,

1 por nuk ju kujtohet emri.

2 Vlen ende kjo, ende kjo është dëshmia juaj?

3 PË. Po, vlen. Ashtu është.

4 PY. Që të jemi të qartë, ky nuk ka qenë një operacion i
5 planifikuar, autorizuar, prej jush nga drejtoria operative,
6 apo jo?

7 PË. Jo, nuk ka qenë i autorizuar.

8 PY. Gjithashtu, keni thënë në intervistën për ZPS-në që nuk
9 mendoni se i shërbeu ndonjë qëllimi ushtarak.

10 PË. Po, saktë. Ashtu e kam thanë.

11 PY. Tani unë do të them, do përdor emrin "operacioni" apo
12 "ofensiva". A është ky operacioni më i rëndësishëm që ka
13 ndodhur nga periudha prej fillimit të qershorit deri në mesit
14 të korrikut? Deri në momentin e Rahovecit flasim. Ka qenë ky
15 më i rëndësishmi para Rahovecit?

16 PË. Çka më kujtohet, Rahoveci ka ndodh njëherë pastaj kjo. Po
17 këto nuk kanë pas rëndësi. Po me ndodh ka ndodh, nuk ka
18 rëndësi për shtabin. Por ndodhi ka ndodh, dhe të cilët kanë
19 ndodh si operacione të cilat nuk janë aprovu nga shtabi, por
20 nga njësitë lokale të cilat pa aprovime kanë veprue.

21 PY. Po. Faleminderit. Sa i takon përgjegjësive që kishte
22 drejtoria operative. Në intervistën për ZPS-në keni qenë shumë
23 i qartë kur keni thënë se të burgosurit, apo çështja e të
24 burgosurve, nuk ishte pjesë e kompetencave të drejtorisë
25 operative. Keni bërë një diskutim për të burgosurit që

1 mendohej se janë ndaluar gjatë operacioneve që përmendëm tek
2 Bardhi i Madh. Kjo është në intervistën tuaj, Pjesa 2,
3 P1355.2, faqja 33 -- 23. Ju pyetën:

4 "A keni mësuar gjë a u mbajtën të burgosur gjatë këtij
5 operacioni?"

6 Përgjigjja juaj:

7 "Nga sa më kujtohet, nuk kam marrë asnjë informacion nga
8 komandanti -- zëvendëskomandanti, unë në atë kohë kisha për
9 detyrë të merresha vetëm me aspektet e çështjeve ushtarake".

10 Këtë i keni thënë ZPS-së. Që të jemi 100 për qind të
11 qartë, keni thënë në dëshminë tuaj ju se drejtorja e
12 operacioneve ushtarake nuk kishte asnjë rol për personat që u
13 burgosën ose që u morën të burgosur gjatë luftimeve? S'kishte
14 asnjë lidhje me këtë?

15 PË. Saktë.

16 PY. Edhe kjo pavarësisht personave që u ndaluan, qofshin këta
17 ushtarë apo civilë, thjesht nuk ishte kompetencë e drejtorisë
18 operative, kështu?

19 PË. Po, saktë. Po, saktë.

20 PY. Ju po flisni për të gjithë drejtorinë operative, nuk po
21 flisni për ju personalisht në këtë kohë, por gjithë drejtorja,
22 apo jo?

23 PË. Po, saktë. Në përgjithësi.

24 PY. A mund të na shpjegoni pse nuk paska qenë ky rol, apo
25 kompetencë e drejtorisë operative?

1 PË. Po, roli dhe kompetenca e drejtorisë operative, e ceka
2 dhe ma herët, pak a shumë e dhashë, nuk është thënë që të
3 merret me këto çështje. Ajo është normalisht të merret me
4 operacionet. Numër një është operacionizimi i njësive,
5 përgatitja e njësive, dhe pastaj të organizojnë mbrojtjen ose
6 të organizojnë sulmet, të aspektit të gjerë, të cilat janë
7 aspekte të operacioneve operative dhe strategjike. Në atë çka
8 ndodh brendapërbrenda saj, zënia rob, e gjitha është në kuadër
9 të komandantit të njësisë në të cili vepron në atë territor
10 dhe i cili kanë marrë atë operacion. Nuk është e drejtorisë
11 operative të merret me atë çështje ose, dhe me burgosjen, e
12 zënia rob. Është sektori juridik i cili merret me çështje dhe
13 komanda adekuate të cilën vepron në atë territor.

14 PY. Atëherë, autoritetin për të burgosurit e luftës që i
15 takon e paska pas komandanti i zonës, kjo vazhdoi gjatë gjithë
16 konfliktit, nuk pati ndonjë ndryshim?

17 PË. Po, është e saktë.

18 PY. Në rregull. Tani të flasim për rolin tuaj dhe kompetencat
19 tuaja personalisht për periudhën nga fillimi i qershorit deri
20 nga mesi i korrikut, dhe periudhën pas 15 korrikut. Kur
21 mbërritët në Kosovë, i thatë Trupit Gjykues javën e kaluar, më
22 3 korrik, ju thatë që kishit rolin e oficerit për zhvillim dhe
23 aftësim pranë drejtorisë operative fillimisht, kështu?

24 PË. Po, kështu është.

25 PY. Të shohim çfarë keni thënë për z. Selimi dhe z. Bashota

1 gjatë intervistës me ZPS-në, por dhe para Trupit Gjykues. Keni
2 përshkruar komunikimet që keni pasur me ta në qershor të 1998.

3 Fillimisht, Pjesa 2 e intervistës me ZPS-në, faqja 3. Do
4 t'ju lexoj atë që keni thënë.

5 "PY. A mund t'ju pyes kur thoni -- anëtari i Shtabit të
6 Përgjithshëm a erdhi me ju atje, apo ishte atje?

7 Kjo është pyetja.

8 "PË. Mendoj se ishte atje. Në fakt ishte atje. Kur më
9 thirrën, në fakt Sokol Bashota më thirri, sepse në atë kohë ai
10 kryesonte drejtorinë operative dhe isha në varësinë e tij, ai
11 lëshonte urdhra për mua. Ai më dërgoi atje, nuk më kujtohen të
12 gjithë personat që kanë qenë atje, por ai më kujtohet."

13 Ju kërkoj ndjesë se pyetjet janë pak të përbëra, por ju
14 po thoni në thelb për z. Bashota që "në atë kohë ai e
15 drejtonte drejtorinë operative dhe se ju ishit në varësinë e
16 tij, dhe ai lëshonte urdhra për ju". Kështu?

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mendoj se do të ishte e drejtë që
18 dëshmitarit t'i citonit për cilën periudhë kohore bëhet fjalë,
19 edhe për rastin.

20 Z. ROBERTS: [Përkthim] Këto janë pyetjet e mia, kështu që
21 Prokuroria mund t'i bëjë pyetjet e veta.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.
23 Kundërshtimi rrëzohet.

24 DËSHMITARI: Po, për atë periudhën.

25 Z. ROBERTS: [Përkthim]

1 PY. Për atë periudhë, flasim qershor 1998, kështu?

2 PË. Po, qershor -- po, qershor 1998.

3 PY. Dhe kjo deri në momentin që morët ju përsipër detyrën më
4 15 korrik 1998, ose rreth datës 15 korrik, kështu?

5 PË. Po.

6 PY. Po ashtu i keni thënë ZPS-së në pjesën 2, faqja 7 e
7 intervistës. Kur ju kanë bërë pyetjen:

8 "Pra, jeni takuar me Sokol Bashotën. Si t'u prezantua?

9 Sipas teje, kush ishte ai?

10 Ju jeni përgjigjur kështu:

11 "Ai u prezantua, m'u prezantua si drejtori i drejtorisë
12 operative pranë Shtabit të Përgjithshëm..."

13 Dëshmitar, a ju kujtohet kjo dëshmi dhe a vlen ende?

14 PË. Po, më kujtohet mirë. Dhe ashtu vlen.

15 PY. Faleminderit. Më 1 korrik 2024, këtu, i keni thënë Trupit
16 Gjykses që z. Bashota ka qenë personi i parë që ju ka dhënë
17 urdhër të shkonit në Drenicë e më pas Rexhep Selimi. A ju
18 kujtohet kjo dëshmi?

19 PË. Po.

20 PY. Më pas u bë një verifikim i dëshmisë, ju treguan, më fal,
21 një dëshmi të çështjes Haradinaj për t'ju rifreskuar kujtesën.
22 Dhe po jua lexoj çfarë u tha. Është transkripti i 1 korrikut
23 2024, referenca është faqja 17345. Prokurorja thotë:

24 "A mund të shkojmë në faqen 757 në të dyja versionet.

25 "PY. Dhe të lexojmë rreshtat nga 2 deri në 7 në shqip.

1 Ju thoni", kjo ka lidhje me dëshminë që keni dhënë më herët në
2 çështjen Haradinaj:

3 "Nuk më kujtohet saktësisht sa qëndrova, a dy a tri ditë.
4 Nuk e di po e di që ka qenë shkurt. Pas kësaj në bazë të
5 urdhrave që më lëshoi komandanti operativ i asaj kohe, Rexhep
6 Selimi, shkova në zonën operative të Drenicës që t'u jepja
7 këshillat e mia se si të përgatitej zona operative e
8 Drenicës."

9 "A është e saktë kjo, Dëshmitar?", ka qenë pyetja.

10 Përgjigjja juaj që keni dhënë më 1 korrik këtu:

11 "Po, saktë. Edhe Rexhep Selimi edhe Sokol Bashota ishin
12 pjesë e drejtorisë operative. Më kujtohet që personi i parë që
13 më udhëzoi kur shkova në terren në Drenicë ka qenë Sokol
14 Bashota, dhe më pas Rexhep Selimi".

15 Fillimisht, a ju kujtohet ky shkëmbim me Prokuroren dhe
16 përgjigja që keni dhënë, kështu?

17 PË. Po, saktë.

18 PY. Që të jemi të qartë, ajo që keni thënë ju më 1 korrik
19 përputhet dhe me atë që i keni thënë ZPS-së më përpara, pra që
20 z. Bashota të është prezantuar si kreu i drejtorisë operative
21 dhe është personi i parë që ju udhëzoi të shkonit në Drenicë,
22 kështu?

23 PË. Po.

24 PY. Dhe vetëm më pas ju udhëzoi apo ju kërkoi dhe z. Selimi
25 të shkonit në Drenicë, por ka qenë një rast i ndarë, apo jo?

1 PË. Po.

2 PY. Kur ua kërkoi apo ju udhëzoi z. Selimi të shkonit në
3 Drenicë, ishte për të njëjtat arsye që ju kishte kërkuar më
4 herët z. Bashota, që të shkonit atje të jepnit këshilla e
5 ndihmë, jo për ndonjë gjë tjetër?

6 PË. Po, po.

7 PY. A kuptoj drejt unë, pra, që ajo që bëri z. Selimi në
8 thelb ishte të përsëriste atë që kishte bërë më përpara z.
9 Bashota?

10 PË. Po, saktë.

11 PY. Z. Selimi u, ju referua urdhrin apo udhëzimit të
12 mëparshëm të z. Bashota kur ju kërkoi të shkonit në Drenicë?

13 PË. Po.

14 PY. Për herë të parë jeni takuar me z. Selimi në fillim të
15 qershorit të 1998. Me sa kam kuptuar unë, ky takim nuk ka qenë
16 në Likovc, por në një shtëpi, ka qenë në një banesë, apo jo?
17 Në një shtëpi.

18 PË. Po, dikund në një shtëpi.

19 PY. Ju kërkoi ndjesë paraprakisht për mënyrën si do shqiptoj
20 fshatin, por ka qenë në një fshat që quhej Plluzhinë?
21 Plluzhinë? Jo në Likovc, por në Plluzhinë?

22 PË. Po, fshati Plluzhinë.

23 PY. Kur u takua me ju z. Selimi, nuk është se ju prezantua me
24 ndonjë titull konkret, thjesht ju ka thënë që punonte në
25 drejtorinë ose departamentin operativ, kështu?

1 PË. Po, saktë.

2 PY. Dhe i thatë ZPS-së më duket se dhe Agim Qelaj ishte pjesë
3 e kësaj drejtorie. Agim Qelaj u kyç në të njëjtën kohë me ju
4 apo ishte atje ku u bëtë ju pjesë e drejtorisë?

5 PË. Jo, të njëjtën kohë.

6 PY. Çfarë pozite kishte z. Qelaj? Të barasvlershëm me ju apo
7 kishte ndonjë rol tjetër?

8 PË. Edhe ai ishte si epror ushtarak, ish-epror, dhe njëjtë
9 edhe ai ka punu në zhvillimin, si oficer në zhvillim dhe
10 profesionalizim. Në cilën pas një kohe kemi dhënë një ushtri
11 që të përgatit dhe ushtron ma tutje ushtarët. Sidomos njësitë
12 ato të reagimit të shpejtë, të cilët i ka marrë si grup dhe ka
13 fillu t'i trajnon. Këto ishin detyrat e tij që ka filluar në
14 fillim të punon dhe ka punuar z. Qelaj.

15 PY. Ai e pati këtë rol deri në momentin që u vra në mes të
16 korrikut, apo jo?

17 PË. Po, saktë. Jo vetëm në mes të korrikut, por të -- po, e
18 saktë, q'ashtu është. Në Rahovec.

19 PY. Në Rahovec, po.

20 PË. Po, po.

21 PY. Ju kërkoj ndjesë, se ju ndërpreva. Për Rahovecin e kisha
22 fjalën, aty ku ra.

23 Më tej i keni thënë ZPS-së se kur mundeshit, në këtë
24 periudhë kohore, qershor deri në mes të korrikut,
25 shoqëroheshit nga z. Selimi dhe shkonit bashkë në zona të

1 caktuara për të dhënë këshilla dhe ndihmë. Tani, a e kam
2 kuptuar drejt unë që ia kërkonit ju z. Selimi të vinte me ju?
3 Si ndodhte që shkonit bashkë?
4 PË. Po, saktë është që kemi shkuar së bashku, për arsye se z.
5 Selimi i ka njoftur të gjithë, i ka njoft këto fshatrat,
6 njësitë, unë nuk i kam njoftur të gjitha. Por, as mu s'më kanë
7 njoftun të tjerët. Kështu që prandaj, së bashku me z. Selimi
8 kemi vizituar këto njësitë. Kemi shkuar të gjitha ato zonat,
9 kur dhe më ka prezantuar edhe kemi punuar në aspektin e
10 këshillëdhënies nëpër zonat e vizitave që kemi bërë në atë kohë.
11 PY. Z. Selimi vinte me kënaqësi me ju, apo jo? Mendonte se
12 dhe ai do të ishte i dobishëm, apo jo?
13 PË. Po, tanë kohën kena qenë bashkë.
14 PY. Dhe punonit mirë me njëri-tjetrin, apo jo? Ndonëse vinit
15 nga, po them, nga përvoja të ndryshme, nga një e shkuar e
16 ndryshme, ju krijuat një marrëdhënie të mirë me njëri-tjetrin?
17 PË. Po, saktë.
18 PY. Dhe sikurse thatë pak më herët, nga banorët e zonave në
19 territoret që shkonit, nuk të njihnin ty, sepse kishit qenë
20 për një periudhë të gjatë, 20 vjet e kusur jashtë Kosovës.
21 Kështu që fakti që z. Selimi vinte me ju, bisedonte me ta, të
22 ndihmonte ty në punën tënde, apo jo?
23 PË. Po, saktë.
24 PY. Në komunikimet që kishit me këta persona, bashkë me z.
25 Selimi, z. Selimi pëlqej nga këta njerëz, kishin besim tek

1 ai?

2 PË. Po shifshin që, u njifshit mes vetit, domethënë kishte
3 besim.

4 PY. A ishte kjo mbase për shkak të rolit që kishte pasur ai
5 për faktin që, për shembull, ai kishte bërë njoftime publike
6 të UÇK-së në nëntor të 1997? Kishte dalë publikisht për UÇK-në
7 në nëntor të 1997

8 PË. Po, e saktë.

9 PY. Dhe mbase për shkak se ishte i afërt me Adem Jasharin,
10 marrëdhënien e besimit që kishin ata me njëri-tjetrin, mbase
11 kjo ndihmoi për marrëdhënien edhe me persona të tjerë apo jo?

12 PË. Po.

13 PY. Megjithatë, kur ishit bashkë, që shkonit për të dhënë
14 ndihma, ai nuk është se u jepte urdhra personave, apo jo?

15 PË. Saktë.

16 PY. Ai jepte këshilla, jepte ndihmë, dhe përpiquej t'i bindte
17 personat e shtabeve lokale dhe u thoshte që këshillat që
18 jepnit ju nga përvoja ushtarake ishin këshilla që ata do t'i
19 ndiqnin, apo jo?

20 PË. Po, saktë.

21 PY. Dhe siç e konfirmuat më herët, ata s'kishin asnjë detyrim
22 që ta bënin. Kështu që ju në njëfarë mënyre përfituat nga
23 fakti që dikush ua shtroi terrenin, ose më lejoni të përdor
24 këtë shprehje, për t'i bindur këta persona, e për të thënë që,
25 shikoni, këto që po ju them unë kanë kuptim nga ana ushtarake,

1 kështu?

2 PË. Po, saktë.

3 PY. Po z. Bashota në atë kohë, ai vinte më pak me ju, apo jo?

4 Ai qëndronte më shumë diku tjetër?

5 PË. Po, saktë. Po, saktë, qe ashtu është.

6 PY. Dhe më pas ju i raportoni z. Bashota në atë periudhë

7 deri në mes të korrikut, i thoni sa të suksesshëm kishit

8 qenë, mbase me kë ishit takuar, çfarë kishit arritur në këtë

9 periudhë kohore, kështu?

10 PË. Po.

11 PY. Gjithashtu, më duket e keni shpjeguar, pra i keni thënë

12 ZPS-së, dhe është në Pjesën 2, faqen 11, se krahas detyrës

13 suaj për të këshilluar dhe ndihmuar këto njësite lokale, ju

14 këshilloni edhe njerëzit të cilët mundësisht mund të

15 emëroheshin, dhe këto propozime ia jepnit Azem Sylës përmes

16 Rexhep Selimit apo Sokol Bashotës. Ju kujtohet që ia keni

17 thënë këtë ZPS-së?

18 PË. Po, saktë është.

19 PY. Por po kështu shpjeguat në seancën tuaj përgatitore me

20 ZPS-në, dhe është me numër P1357, paragrafi 13 [Sipas

21 përkthimit] që këto rekomandime, thjesht bënit rekomandime,

22 nuk merrnit pjesë në diskutimet apo komunikimet e mëparshme

23 dhe nuk e dinit se kush e merrte në fund vendimin për të

24 emëruar një individ, kështu?

25 PË. Po, saktë është.

1 PY. Por me aq sa ju kujtohet juve, propozimet tuaja
2 ndiqeshin, apo jo?

3 PË. Po.

4 PY. Në intervistën tuaj me ZPS-në përshkruani disa probleme
5 organizative, nëse mund ta them kështu, gjatë verës së 1998,
6 kur z. Bashota ju ka thirrur dhe ju ka caktuar që të shkoni në
7 një vend të caktuar. Për shembull keni shkuar në Drenoc për të
8 ndërmjetësuar për problemet midis shtabeve lokale të Drenocit.
9 Ju kujtohet kjo?

10 PË. Po.

11 PY. Po kështu i keni thënë ZPS-së ju është ngarkuar detyra
12 nga z. Bashota për të shkuar në shtabin lokal të Prizrenit e
13 për ta ndihmuar këtë shtab lokal për t'u riorganizuar. Po
14 citoj nga intervista juaj me numër P1355.2, Pjesa 2 e
15 intervistës, faqja 13 -- do ta bëj të gjithë, do ta lexoj të
16 gjithë paragrafin:

17 "... është një person, pra kishte një person. Pastaj
18 kishte ndërlikime me zonën operative të Pashtrikut. Unë kështu
19 e kam kuptuar asokohe. Këta tre persona Zafiri, Elbasan
20 Shoshaj dhe Ismet Kryeziu kanë ardhur në këtë pjesë nga zona
21 operative e Pashtrikut. Erdhën tek Sokol Bashota e kanë
22 kërkuar ndihmë për të riorganizuar shtabin lokal të Prizrenit.
23 Sokol Bashota pastaj më ka thirr mu, ai më thirri dhe më
24 ngarkoi detyrën që të shkoja në shtabin lokal të Prizrenit për
25 ta ndihmuar këtë shtab lokal, për të organizuar shtabin lokal

1 të Prizrenit.”

2 Ju kujtohet që i keni thënë kështu ZPS-së?

3 PË. Po, saktë, ashtu është.

4 PY. Dhe më duket se ju ka dërguar dhe në Drenoc, apo jo, për
5 të ndërmjetësu për një problem aty?

6 PË. Po.

7 PY. Në të dy këto raste, shtabet lokale e kishin, i kishin
8 kërkuar atij që të dërgonte dikënd, edhe ai ju dërgoi juve,
9 kështu e mendoni?

10 PË. Po, ashtu e mendoj.

11 PY. Pra, nuk është se ju po ia kërkonit ju apo donit ju, ia
12 impononit, pra, vullnetin tuaj -- vullnetin tuaj apo vullnetin
13 dhe e drejtorisë operative mbi këto njësite. Thjesht ju
14 drejtoheshin këto njësi juve, ju kërkonin një zgjidhje, një
15 zgjidhje të mundshme, të cilën ato mund ta ndiqnin ose jo. Por
16 fatmirësisht ato e kanë ndjekur ma merr mendja?

17 PË. Po, ashtu është.

18 PY. I keni thënë Trupit Gjykses më 3 korrik, pra dita e tretë
19 e dëshmisë suaj javës së shkoi që z. Selimi ishte i pranishëm
20 në Kosovë gjatë korrikut, gjatë qershorit dhe korrikut të
21 1998. Ju kujtohet kjo?

22 PË. Po.

23 PY. Keni përshkruar një takim, datë 28 qershorit të 1998, në
24 Suharekë, që ju e keni konfirmuar se keni marrë pjesë në të,
25 kur njësitet Çeliku 50 dhe njësite të tjera kanë vendosur që

1 të bashkohen me njëra-tjetrën, ju kujtohet?

2 PË. Po.

3 PY. z. Selimi nuk merrte pjesë në atë takim, apo jo?

4 PË. Jo, nuk ka qenë.

5 PY. Ju kujtohet arsyeja pse s'ka qenë?

6 PË. Jo, për arsye se kam shkue t'i ndihmoj këtyne dy njësive
7 që të bashkohen. Kam shkue dhe në atë kohë me z. Bashota se më
8 ka treguar që ka disa lëvizje dhe probleme me këto njësi
9 lokale. Dhe për atë kam shku atje dhe bisedën e kam zhvillu me
10 këto dy njësi të cilat i kam ndihmuar që të afrohen me to.

11 Ka qenë edhe një person tjetër, është Gafur Elshani. Edhe
12 ai është i territorit të Suharekës, ndryshe ka qenë i njoftur
13 me të gjitha dhe të njësitit Çeliku dhe njësitit Lisi dhe ka
14 qenë çka di në organizimet e mahershme të UÇK-së dhe ka pas
15 një autoritet dhe kështu që të dy kemi shfrytëzuar këtë
16 autoritetin dhe kemi bashku këto dy, i kemi ndihmu të
17 bashkohen të dy njësitë.

18 PY. Ju kërkoj ndjesë nëse jeni përgjigjur dhe më përpara
19 kësaj pyetjeje, por ata -- pra ky është një tjetër shembull që
20 ata vetë ju janë drejtuar me një kërkesë për të shkuar për t'i
21 ndihmuar me praninë tuaj?

22 PË. Po, saktë.

23 PY. Nëse do të thosha se arsyeja që z. Selimi s'ndodhej në
24 atë takim në fund të qershorit ishte se ai ishte rrugës për
25 Shqipëri ose kishte mbërrit ndërkohë në Shqipëri. A përputhet

1 kjo me atë çka mbani mend ju?

2 PË. Mund me qenë dhe ajo punë, nuk e kam pas, se pastaj se
3 pas atij takimi kam shkuar për, me detyrë tjetër në territorin
4 e Prizrenit.

5 PY. Në fakt do të kalojmë më pas në Rahovec, më vonë sot ose
6 mundet dhe nesër. Por, gjatë kësaj periudhe, ju kujtohet kur e
7 patë herës tjetër në Rahovec apo diku tjetër?

8 PË. Po, në Rahovec. Së pari ma herët e kam pa, para se të
9 fillon Rahoveci, kur kemi shku në vizitë në Dukagjin. Atëherë,
10 pastaj në Rahovec.

11 PY. Po, kur thoni më herët në Dukagjin, rreth 15 a 16
12 korrikut [Korrigjim i përkthyesit: 14 apo 15 korrikut]? Më
13 falni, jo gjithmonë, e kuptoj që datat jo gjithmonë mund të
14 kujtohen.

15 PË. Datat jo fort, por di që ka qenë tri ditë para se të
16 fillon sulmi në Rahovec. Kur ishim ne në Dukagjin. Kur
17 përmenda dhe takimin e mëhershëm në Jabllanicë.

18 PY. Po, po. Më duket se jua ka bërë disa pyetje z. Emmerson
19 për këtë. E kam të saktë se nuk ju kujtohet ta keni parë z.
20 Selimi, le të themi, midis datës së këtij takimi lidhur me
21 njësitin Lisi në qershor, dhe deri në këtë takim tjetër 14
22 deri në 15 korrik? Nuk ju kujtohet ta keni parë në këtë
23 periudhë të ndërmjetme z. Selimi?

24 PË. Jo, nuk më kujtohet.

25 PY. T'i kthehemi tani fillimit të qershorit kur e keni takuar

1 për herë të parë z. Selimi. I keni thënë ZPS-së dhe dua të jem
2 shumë i qartë me saktësi lidhur me këtë, i thatë ZPS-së
3 asokohe Rexhep Selimi ishte komandant i operacioneve. Në fakt,
4 ta citoj pjesën që të jetë më se e qartë. Është Pjesa 2,
5 P1355.2, në faqen 8:

6 "PY. Kishit dijeni se Rexhep Selimi ose le të -- më
7 lejoni t'ju pyes, cili kishit ju dijeni ishte komandanti
8 operativ asokohe?

9 Dhe ju jeni përgjigjur:

10 "Asokohe, mendoj se ka qenë Rexhepi."

11 Ju kujtohet që i keni thënë kështu ZPS-së?

12 PË. Mund me u kanë, por çka i përket, nuk kam thanë
13 "komandant" se nuk ka pas komandant. Drejtoria operative,
14 drejtori i drejtorisë operative, drejtorët operativë kanë qenë
15 dy, domethënë edhe Sokoli edhe Rexhepi.

16 PY. Po kjo do të thotë që s'jam i detyruar atëherë të bëj
17 tre-katër pyetjet e tjera sepse vërtet s'kishte komandant,
18 shumë e qartë, pra, nuk ekzistonte një rol i tillë si
19 komandanti i operacioneve. Pra, nuk ekzistonte ky term? Apo
20 jo?

21 PË. Po, ashtu është.

22 PY. Pra, dëshmia -- pra ju po thoni, në dëshminë tuaj, siç e
23 kuptoj, është që z. Selimi ndodhej në drejtorinë operative
24 asokohe, z. Bashota ishte shef i kësaj drejtorie, dhe ishit
25 edhe ju pjesë e kësaj drejtorie?

1 PË. Po, kjartë. Si edhe ma herët e shpjegova.

2 PY. Të kalojmë tani rreth datës 15 korrik. Më 1 korrik -- jo,
3 më falni, më 1 korrik 2024, faqja e transkriptit T17369, keni,
4 ju shpjeguat se ju jeni, ju kanë informuar se ishit shef i
5 drejtorisë operative dikund nga mesi i korrikut tri a katër
6 ditë para ofensivës së Rahovecit. Dhe besoj se ju konfirmuat
7 sërish se ishte 3 korriku. Dhe këtë e shpjeguat për, e
8 konfirmuat sërish më 3 korrik, më falni.

9 Dhe tani sigurisht e shpjeguat, pra, që ishte, shpjeguat
10 pra lidhur me takimin në të cilin ju ndodheshit në Jabllanicë
11 nja dy ditë përpara Rahovecit, dhe duket se është koha kur ju
12 morët edhe detyrën e shefit të drejtorisë operative, a nuk
13 është kështu?

14 PË. Po, kështu është, por pak se shumë, një datë me u
15 propozit 3 korrik, çka ka lidhje 3 korriku me mbledhjen në
16 Jabllanicë? Po a përkthimi mund me kanë, apo çka është, nuk e
17 di.

18 PY. Jo, mbase është mungesa ime e qartësisë në pyetjen time.
19 E kisha fjalën që këtu keni dhënë dëshmi në 3 korrik të vitit
20 2024, dhe atë dëshmi a e konfirmoni, sepse duhet t'jua kisha
21 thënë me vit, faktikisht. Po, keni të drejtë. Shpresoj që
22 është e qartë tani. Pra, që ju e morët këtë detyrë nga mesi i
23 korrikut, datë 14 a 15 korrikut?

24 PË. Po, kjartë.

25 PY. Dhe asokohe, ju morët përsipër përgjegjësitë dhe detyrat

1 e z. Bashota, apo jo?

2 PË. Po.

3 PY. Z. Bashota, pastaj çfarë bëri më mbrapa? Ku kaloi?

4 PË. Nuk e di. Me ato se [E padëgjueshme] sepse sikur mbi të,
5 si strukturë çfarë ka qenë shtabi, por edhe ofensiva edhe që
6 të cilat i kemi pas, nuk ka pas mundësi as të lëvizet diku se
7 të thuhet është lëviz në këtë pozicion apo me tregu se cili
8 është pozicioni i tij i matutjeshëm. Nuk e kam dit. Tek, kur
9 kemi bo ristrukturimin atëherë është në këtë pozicionin,
10 pastaj, si zëvendëskomandant për operacionet.

11 PY. Dhe kjo ka ndodhur shumë më vonë në 1998, apo jo?

12 PË. Po, saktë.

13 PY. Gjatë asaj periudhe, korrik, gusht, ju e dini se cila
14 ishte pozita juaj, sepse ju kishin emëruar, por kishte shumë
15 paqartësi se kush ishte çfarë në mbarë Shtabin e Përgjithshëm?

16 PË. Po, saktë.

17 PY. Kjo paqartësi, madje sigurisht edhe për ju vetë si shef i
18 shtabit, a vazhdoi edhe derisa ju keni dalë në Shqipëri, më
19 duket diku nga mesi i shtatorit?

20 PË. Po, diku fillimit të shtatorit kam dalë. Por ka vazhdu
21 q'ashtu e njëjtë, se deri edhe të, thua je, deri kur jam kthyer
22 në prej Shqipërisë nëntor, po, e kemi filluar ristrukturimin e
23 Shtabit të Përgjithshëm.

24 PY. Pra, vetëm nga nëntori mund të thuhet, është që ju ishit
25 fort i qartë se cilat ishin pozitat kush ishte kush, por gjer

1 atëherë ishte shumë e ndërlikuar për të kuptuar, ishte e
2 vështirë për të kuptuar se cilët ishin personat që mbanin
3 pozita të caktuara?

4 PË. Po, saktë.

5 PY. Edhe një pyetje, çfarë qëndrimi ka mbajti z. Selimi sa i
6 takon emërimin tuaj në atë pozitë, a e ka mbështetur ai emërimin
7 tuaj si shef shtabi?

8 PË. Po.

9 PY. Dhe sigurisht e diskutuam dhe më përpara, sa i takon
10 marrëdhënies pozitive që keni zhvilluar ju gjër atëherë, a ka
11 pasur ai edhe të njëjtën qëndrim pozitiv kundrejt z. Qelaj, që
12 ju e cekët, ishte përgjegjës për batalionin dhe për
13 stërvitjen, më duket?

14 PË. Po, përgjegjës për stërvitjen, po.

15 PY. Dhe, pra, "po," z. Selimi kishte marrëdhënie të mirë me
16 atë?

17 PË. Po, e ceka. Po, thashë.

18 PY. Dhe e ka respektin, ka pas respekt për përvojën e tij
19 ushtarake dhe për atë çka mund të kontribuonte, të sillte në
20 UÇK?

21 PË. Po.

22 PY. Më duket se i keni thënë ZPS-së se është vrarë në betejë
23 rreth Rahovecit nga mesi i korrikut, po kështu i keni thënë
24 ZPS-së se si ju, z. Thaçi dhe z. Selimi keni shkuar në zonën e
25 Llapit në gusht të vitit 1998, sepse kishit marrë informacion

1 se z. Qelaj kishte, ishte lëndu, ishte plagos dhe ndodhej në
2 një spital të Prishtinës, kështu?

3 PË. Po, kështu është. E saktë.

4 PY. Ky ishte qëllimi kryesor i këtij udhëtimi përmes zonës së
5 Llapit për në Prishtinë, kështu? Domethënë, qëllimi kryesor,
6 të paktën për z. Thaçi dhe z. Selimi të themi?

7 PË. Po, saktë.

8 PY. Dhe zona, më falni, dhe shtabi i zonës së Llapit, apo aty
9 ku ata e kanë vazhdu rrugën, ishte në veri të Prishtinës, apo
10 jo? Atëherë pse i ranë asaj rruge për me shku në Prishtinë,
11 pse nuk shkuan drejt e në Prishtinë?

12 PË. Për arsye se zona e Llapit ka pas dhe njerëz të vet
13 ushtarët e vet edhe në Prishtinë dhe të cilët i ka pas këtë
14 territor si e ka në kontrollin e tij. Një, e dyta, dhe ka
15 njoft ma mirë atë territor, dhe ka pas këto vijat për me hy
16 brenda me mujt me vizitue domethënë ato çka, për çka është
17 shku të vizitohet. Që nuk ka mujt të shkojmë na prej
18 territorit të Drenicës të shkojmë në Prishtinë dhe se s' kemi
19 pas asij vija, as kem pas ato kontrollet e atyne që jemi mujt
20 me hy deri në Prishtinë. Kurse nga zona e Llapit, po, kemi
21 mujt.

22 PY. Pra, ishte e vetmja mënyrë se si z. Selimi mund të
23 shkonte në Prishtinë për të parë nëse ky informacion ishte i
24 saktë, ishte përmes zonës së Llapit?

25 PË. Po, saktë.

1 PY. Megjithatë, edhe kjo rrugë ishte jashtëzakonisht e
2 rrezikshme për të hyrë në Prishtinë, për z. Selimi po flas, i
3 cili edhe mund të njihej aty në mes të gushtit të vitit 1998?

4 PË. Po, saktë për çdonjënjin ka qenë e rrezikshme, pa marrë
5 parasysh, edhe pse ka qenë një rrugë e cila sado, kado, ka
6 qenë ma e organizume ose me një lloj kontrolli, por rreziku
7 permanent ka ekzistuar çdo herë.

8 PY. Nëse z. Selimi do ta kapnin rob një numër i madh i
9 forcave serbe në Prishtinë asokohe, çfarë kishte për t'i
10 ndodh?

11 PË. Ose do të arrestohej ose do të vritej menjëherë.

12 PY. Dhe kjo rrugë vetëm e vetëm për të parë pra, nëse, z.
13 Qelaj, për të vizitu z. Qelaj i cili punonte për ju në
14 drejtorinë operative, pra ky "mision i rrezikshëm" nëse mund
15 ta them kështu?

16 PË. Po, saktë.

17 PY. Pra, tani t'i kthehemi qershorit apo korrikut përpara se
18 ju të merrnit detyrën. Më duket se i keni thënë ZPS-së se ju
19 kishit dëgjuar për një bllok shënimesh, bllok xhepi, të cilin
20 z. Selimi ia kishte dhënë Kryqi i Kuq, bllok -- një libër
21 xhepi, më falni, libër xhepi që z. Selimi ia kishte dhënë
22 Kryqi i Kuq, të cilin ai pastaj ia dha disa prej këtyre
23 komandantëve lokalë në bazë, kështu?

24 PË. Po, kështu. Po, kështu është.

25 PY. Dhe kjo ka ndodh përpara se ju të hynit në Kosovë, pra

1 përpara majit 1998?

2 PË. Po, mund edhe para se të --

3 PY. 29 majit, më falni.

4 PË. -- të kam njohuri, faktikisht, të marr këtë detyrë.

5 PY. A e dini se kujt, kush i mori, domethënë, kujt iu dhanë
6 këto libra xhepi në të cilat zona.

7 PË. Jo, nuk e di. Dhe simbas kësaj që është spjegju, edhe e
8 kam pas pyet edhe z. Rexhepi, më ka tregu që, po, e ka
9 shpërnda, por ku, në cilat zona, nuk kam hy ma tutje.

10 PY. Pasi ju kanë emëruar si shef shtabi në mes të korrikut,
11 pra, flasim për mesin e korrikut të 1998, ju e morët detyrën
12 pra, në mes të korrikut 1998. Jeni gjendur përballë një
13 vështirësie, pra një detyrë shumë të vështirë, sepse veç
14 ofensiva serbe po zhvillohej ngado.

15 PË. Po, saktë është. Së pari nuk kam marrë detyrën e shefit
16 të shtabit, por drejtorisë operative. Mbase sipas përkthimit
17 që po më del këtu. Vështirë ka qenë mjaft shumë, se menjëherë
18 mbasi e kam marrë detyrën, mbas dy ditëve, tri, ka fillue
19 ofensiva, dhe nuk është ndalun deri në tetor këto ofensiva.
20 Kështu që, nuk ka qenë e lehtë. Jo veç për mu, por kushdo ta
21 kishin marrë.

22 Nuk ka qenë e lehtë kjo detyrë të zhvillohet ose të
23 punohet si drejtoria operative për shkak edhe të ofensivave që
24 kanë ndodhur në atë kohë.

25 PY. Kërkoj ndjesë, është gabim nga ana ime, e kisha fjalën

1 për shefi i drejtorisë operative në mes të korrikut. Pra, po
2 zhvillohej ofensiva serbe, korrik, pra mes korrik, gusht,
3 shtator, dhe deri në tetor. Pra, sigurisht asokohe kishte
4 ushtarë të cilët janë vra, ushtarë të tjerë të cilët janë
5 kthyer në vendet e tyre, prej nga kishin ardh, apo ku po
6 jetonin. Gjithsesi, a ka ndodh edhe kjo kështu?

7 PË. Po, ashtu është.

8 PY. Pra, kishit edhe mungesa në armë dhe në municione, apo
9 jo?

10 PË. Po, saktë.

11 PY. Dhe me thënë të drejtën, ishit në minorancë sa i takon
12 armëve, në kuptimin që forcat serbe ishin në nivele shumë më
13 superiore sa i takon artilerisë, tankeve, gjithçka tjetër që
14 mund t'ju duhej për të bërë një luftë moderne?

15 PË. Po, saktë.

16 PY. Dhe në këto kushte ka ndodhur që ju po përpiqeshit që të
17 bënit këtë ristrukturim, për të parë se deri ku këto njësi të
18 shtabeve lokale -- për të cilat folëm më herët, për t'i kthyer
19 këto në një farë forme të një strukture ushtarake, më të
20 dallueshme që ishte ushtarake.

21 PË. Po. Ishte përpjekje të shkojmë në strukturimin e saj, dhe
22 profesionalizimin e saj.

23 PY. Nuk ishte aspak detyrë e lehtë, pikërisht për shkak të
24 këtyre faktorëve për të cilët folëm.

25 PË. Po, saktë.

1 PY. Për procesverbalin, është e qartë që z. Qelaj ishte
2 vrrarë. Z. Bashota, ju thatë, nuk ishit i sigurt, pra ma merr
3 mendja nuk kishit shumë kontakt me të në drejtorinë operative
4 pra gjatë korrikut, gushtit, dhe shtatorit. Gjatë kësaj kohe
5 ka ndodhur që ju keni kërkuar që të vinin dhe persona të tjerë
6 dhe të kyçeshit [Korrigjim i përkthyesit: dhe të kyçeshin
7 ata], në drejtorinë operative? Më duket se e cekët këtë këtu
8 në sallën e gjyqit javën që shkoi.

9 PË. Po, e saktë. Ashtu është.

10 PY. Kjo ka qenë koha kur Naim Maloku i cili pati mundësi t'ju
11 bashkohej, por dikush tjetër nuk pati mundësi, se s'më
12 kujtohet tamam.

13 PË. Koha është që kam kërku ka qenë korriku, pastaj gushti.
14 Por prej tyne që kanë ardhur, pastaj në shtator, faktikisht,
15 në fund të gushtit, fillim të shtatorit, ka ardh veç Naim
16 Maloku nga eprorët, të cilët ka ardh në drejtorinë operative.
17 Të tjerët jo.

18 PY. Pra, në thelb, deri në fund të shtatorit, ju nga katër
19 njerëz që ishit në fillim ratë në dy a tre, domethënë, në
20 drejtorinë operative, kështu?

21 PË. Po.

22 PY. Edhe një pyetje të fundit përpara se ta ndërpresim
23 seancën për sot. E kam të drejtë nëse them se gjatë të gjithë
24 kohës tuaj në UÇK, nuk keni marrë asnjëherë një gradë zyrtare?

25 PË. Jo veç unë, por askush s'ka pas grada zyrtare. Se s'ka

1 pas gradime.

2 PY. Dhe kjo binte ndesh me armën [Sipas përkthimit] e Bosnjës
3 kur ishit, më duket, nënkolonel, apo jo?

4 PË. Po.

5 PY. Faleminderit shumë z. Zyrapi. Këtu mbyllem pyetjet e mia
6 sot. Shpresojmë që të shihemi prapë nesër, të pushoni sot,
7 shpresoj.

8 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
10 z. Zyrapi për praninë tuaj këtu sot. Këtu mbyllet dita juaj
11 për ju sot. Do të rishihemi nesër në orën 9.00. Ju rikujtoj të
12 mos flisni me askënd jashtë kësaj salle të gjyqit për dëshminë
13 tuaj. Nëse dikush përpiqet që t'ju kontaktojë, që të flasë,
14 për dëshminë tuaj këtu, na thoni menjëherë.

15 Ju uroj ditë të mbarë.

16 DËSHMITARI: Faleminderit.

17 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, z.

19 Roberts.

20 Z. ROBERTS: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës. Sa i takon
21 se ku jemi aktualisht me këtë dëshmitar, besoj se do të ishte
22 e dobishme që në një moment, sa më shpejt të bënim një
23 diskutim realist se kush do të paraqitet si dëshmitar nëse do
24 këtë të tillë në javën e ardhshme. Sa më shpejt ta marrim këtë
25 informacion, aq më mirë, në mënyrë që të bëjmë dhe ne planet

1 tona.

2 Hë për hë, kemi dijeni që mundësisht janë disa
3 dëshmitarë, që janë parashikuar për javën e ardhshme. Nuk do
4 t'i përmend ata tani, por për secilin prej tyre kemi nevojë
5 për parapërgatitje të konsiderueshme.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni
7 informacion?

8 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Shpresoj që ta kemi këtë
9 informacion deri në fund të ditës sot dhe pastaj ta cekim kur
10 të jetë nevoja.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
12 që ta mbyllim këtë çështje deri në fund të ditës nesër. Që të
13 jetë plan i mirë. Faleminderit shumë për praninë, do të
14 rishihemi nesër në orën 9.00. Nesër e kemi ditën e plotë, siç
15 e kuptoj.

16 --- Seanca përfundon në orën 13.00

17

18

19

20

21

22

23

24

25